

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7163
E hënë, 15 prill 2024
Çmimi 0.50

Osmani: Gjurmët e krimeve të dhunës seksuale vazhdojnë të rëndojnë jetën e qytetarëve | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KURTI PRET QË KOSOVA TË BËHET ANËTARE E KËSHILLIT TË EVROPËS | FAQE 5



Kryeministri Albin Kurti ka thënë të dielën se pas zbatimit të aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me çështjen e Manastirit të Deçanit, pret që Kosova të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës. "Pas dy ditëve, më 16 prill, do ta kemi

votimin më të rëndësishëm deri më sot në këtë proces, me ç'rast Asambleja Parlamentare pritet ta miratojë opinionin e znj. Bakoyannis i cili rekomandon anëtarësimin e plotë të Kosovës, pa asnjë parakusht shtesë dhe pa fusnotë", ka thënë Kurti, duke

shtuar se betejën e radhës e të fundit për këtë proces do ta kemi deri në mesin e muajit maj, kur mbahet ministeriali i Këshillit të Evropës i cili duhet ta ftojë Kosovën që të bëhet anëtarja e 47 e organizatës më të madhe dhe më të vjetër të kontinentin tonë

AKTUALE



USHTRIA SERBE AFËR BUJANOVCI, VLERËSOHET KËRCËNIM NDAJ KOSOVËS | F. 5

KATËR MUJ NGA NGRITJA E AKTAKUZËS PËR MASAKRËN E MEJËS, ENDE NUK U PUBLIKUA NË GAZETËN ZYRTARE | F. 6

HOTI: TRI VITE NGA VENDOSJA E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE, KOSOVA ENDE NUK KA AMBASADOR NË IZRAEL | F. 3

EKONOMI



KREU I BORDIT TË ZRRE-së: ELEKTROSEVERI PO I ZBATON LIGJET E KOSOVËS | F. 7

PARANDALOHET KONTRABANDA E CIGAREVE NË HAN TË ELEZIT, VLERA E MALLIT 3 000 EURO | F. 7

SPORT



LLAPI GABON SËRISH, FITOJNË BALLKANI DHE DRITA | F. 12

IZRAELI ZMBRAPS SULMET IRANIANË ME NDIHMËN E ALEATËVE, TENSIONET MBETEN TË LARTA | F. 2



HAZIRI: EDI RAMA KA MARRË ROL KRITIK NË DIALOG, KJO KA RËNDËSI TË MADHE DHE DUHET TË GËZOHEMI | F. 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli zbraps sulmet iraniane me ndihmën e aleatëve, tensionet mbeten të larta



G7 dënon Iranin për sulmin ndaj Izraelit, paralajmëron mbi rrezikun e përshkallëzimit

Udhëheqësit e vendeve të G7-s dënuan sulmin e Iranit ndaj Izraelit dhe thanë të dielën se do të punojnë për të frenuar një "përshkallëzim rajonal të pakontrolluar" të konfliktit në Lindjen e Mesme.

Italia, e cila mban presidencën e radhës të G7-s, kishte thirrur një takim të udhëheqësve të vendeve më të zhvilluara të botës pasi presidenti amerikan Joe Biden premtoi një përgjigje të koordinuar diplomatike ndaj sulmit të pashembullt të Iranit me dronë dhe raketa ndaj Izraelit. "Me veprimet e tij, Irani ka thelluar destabilizimin e rajonit dhe rrezikon të provokojë një përshkallëzim rajonal të pakontrollueshëm të konfliktit. Kjo duhet të shmanget", thuhet në deklaratën e lëshuar nga Italia.

Udhëheqësit e G7-s, të cilët mbajtën një takim virtual, që zgjati pak më pak se një orë, i bënë thirrje Iranit të tregohet i përmbajtur. "Në këtë frymë, ne kërkojmë që Irani dhe grupet e mbështetura prej tij, të ndërpresin sulmet e tyre dhe ne jemi të gatshëm të marrim masa të mëtejshme tani dhe në përgjigje të nismave të tjera destabilizuese", thuhet në deklaratën e G7-s.

Presidenti Biden ka paralajmëruar kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu se Shtetet e Bashkuara nuk do të marrin pjesë në një kundërsulm ndaj Iranit, nëse Izraeli vendos të hakmerret.

Veprimet e Iranit ishin në përgjigje të një sulmi të dyshuar izraelit në konsullatën e tij në Siri më 1 prill, në të cilin u vranë komandantët kryesorë të Gardës Revolucionare dhe pasojnë përleshjet disa mujore mes Izraelit dhe aleatëve rajonalë të Iranit, të shkaktuara nga lufta në Gaza.

Deklarata e G7-ss gjithashtu premtonte fillimin e punës për arritjen "e një armëpushimi të menjëhershëm dhe të qëndrueshëm" në Rripin e Gazës pas më shumë se gjashtë muajsh luftimesh atje.

G7 përbëhet nga Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Italia, Britania, Franca Gjermania dhe Japonia, si dhe Bashkimi Evropian. Ministrat e jashtëm të G7-s kanë në plan të zhvillojnë një takim në 17-19 prill në ishullin italian të Kaprit.

Në një veprim të paprecedentë, Irani sulmoi të shtunën Izraelin ndërsa mbrojtja ajrore e këtij të fundit e ndihmuar edhe nga aleatët, ShBA, Britania, Jordania dhe Arabia Saudite arritën të rrëzojnë rreth 99 % të më shumë se 300 dronëve dhe raketave të lëshuara nga Irani. Por tensionet mbeten të larta, mes frikës për përshkallëzim të mëtejshëm në rast të një kundërsulmi të mundshëm izraelit. Ekspertët thonë se ky sulm shënoi një kapitull të ri në histori.

JERUSALEM, 14 PRILL - Izraeli njoftoi të dielën se kishte përballuar me sukses sulmin e paprecedentë nga Irani, ndërsa ushtria izraelite dhe aleatët rrëzuan 99% të më shumë se 300 dronëve dhe raketave të lëshuara drejt territorit izraelit. "Të shtunën Irani ndërmoi një sulm kundër Izraelit dhe nisi më shumë se 300 dronë dhe raketa. Kërcënimi iranian u përball me epërsinë ajrore dhe teknologjike të Forcave të Mbrojtjes të Izraelit së bashku me një koalicion të fortë me aleatët, i cili së bashku goditi shumicën e dronëve dhe raketave. Ne goditëm 99% të kërcënimeve të lëshuara ndaj territorit të Izraelit. Kjo është një arritje strategjike shumë e rëndësishme", tha zëdhënësi i Ushtrisë izraelite.

Por tensionet rajonale mbeten të larta, mes frikës për përshkallëzim të mëtejshëm në rast të një kundërsulmi të mundshëm izraelit.

Një zyrtar i lartë amerikan tha se Uashingtoni e kishte informuar Izraelin se nuk planifikon të godasë vetë Iranin. Sulmet iraniane ndaj Izraelit ndodhën pas një sulmi ajror në një ndërtesë konsullore iraniane në Siri në fillim të këtij muaji, ku u vranë dy gjeneralë iranianë. Izraeli as nuk e ka konfirmuar dhe as mohuar përgjegjësinë për këtë sulm. "Mendoj se trysnia ndaj udhëheqësit suprem Ayatollah Khamenei u rrit deri në pikën ku Irani e ndjeu se ishte e nevojshme që nëse nuk i kryente këto sulme ndaj Izraelit, Izraeli thjesht do të vazhdonte të merrte gjeneralët iranianë një nga një", thotë për Zërin e Amerikës, Barbara Slavin, eksperte pranë qendrës "Stimson".

Prej vitesh, Izraeli dhe Irani kanë zhvilluar një luftë në hije me incidente si sulmi ndaj konsullatës në Damask, por sulmet e së shtunës ishin sulmet

e para të drejtpërdrejta iraniane ndaj Izraelit, pavarësisht dekadave të armiqësisë që daton që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979. "Ky është një kapitull i ri për historinë e Lindjes së Mesme. Deri në këtë pikë, as Irani dhe as Izraeli nuk e kishin sulmuar drejtpërdrejt njëri-tjetrin nga territori i tij. Irani tani e ka ndryshuar këtë. Për Izraelin, kjo do të thotë se Irani mund të bëjë sulme të ngjashme në të ardhmen. Po kështu, kjo do të thotë se Izraeli tani ka të drejtë ta bëjë të njëjzat sulme kundër vetë Iranit. Veprimet e Iranit kanë ndryshuar rrjedhën e dinamikës së sigurisë rajonale", thotë për Zërin e Amerikës eksperti Norman Roule. "Përshkallëzimi i dhunës është shumë i rrezikshëm. Shumë prej nesh që e kemi parë me habi luftën e Gazës gjatë 6 muajve të fundit, jemi të shqetësuar se ky lloj përshkallëzimi mund të sillte një konflikt më të gjerë, nëse situata në Gaza nuk zgjidhet shpejt", thotë për Zërin e Amerikës Barbara Slavin, eksperte pranë qendrës "Stimson".

Izraeli ndër vite ka krijuar me ndihmën e Shteteve të Bashkuara një sistem të mbrojtjes ajrore, i aftë të përballojë një sërë kërcënimesh, duke përfshirë raketa me rreze të gjatë, dronë apo raketa me rreze të shkurtër veprimi.

Ky sistem, së bashku me avionët amerikanë, britanike dhe të aleatëve të tjerë bënë që Izraeli

të përballonte me sukses sulmin masiv iranian, ndërkohë që ushtria është në luftë me grupin militant Hamas në Gazë dhe Hezbollahun në Liban. Si Hamasi ashtu edhe Hezbollahu mbështeten nga Irani. "Teknologjia iraniane nuk arriti të depërtojë përtej mbrojtjes ajrore perëndimore. Po ashtu ushtria iraniane ishte në gjendje të demonstronte se ishte e gatshme të godiste Izraelin. Pavarësisht reputacionit ushtarak të Izraelit dhe pavarësisht mbështetjes së Izraelit nga Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar. Por është e pamundur të thuhet sonte se Irani do të largohet nga ky sulm me ndjenjën se ka frenuar Izraelin apo Shtetet e Bashkuara", thotë eksperti Norman Roule për Zërin e Amerikës.

Gjenerali Mohammad Hossein Bagheri, shefi i Shtabit të Forcave të armatosura iraniane, tha se operacioni kishte përfunduar, njoftoi agjencia shtetërore e lajmeve IRNA. "Ne nuk kemi ndërmend të vazhdojmë operacionin kundër Izraelit", citohet të ketë thënë ai. Presidenti i Iranit, Ebrahim Raisi, pretendoi se Irani i kishte dhënë një mesim Izraelit dhe paralajmëroi se "çdo aventurë e re kundër interesave të kombit iranian do të përballej me një përgjigje më të rëndë dhe pa keqardhje nga Republika Islamike e Iranit".

Osmani: Gjurmët e krimeve të dhunës seksuale vazhdojnë të rëndojnë jetën e qytetarëve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të dielën se gjurmët e krimeve të dhunës seksuale, të kryera nga ushtria e policia serbe në luftën e fundit në Kosovë, vazhdojnë të rëndojnë edhe sot jetën e qytetarëve, edhe 25 vjet pas luftës. Ajo i ka bërë këto deklarata më 14 prill, datë në të cilën Kosova përkujton të mbijetuarit e dhunës seksuale nga koha e luftës.

Ajo ka thënë se në ditë si kjo, të gjithë qytetarët e Kosovës reflektojnë mbi vuajtjet dhe shprehin solidaritetin me të gjithë ata që kanë përjetuar këtë "tragjedi njerëzore".

"Shënimi i 14 prillit është më shumë sesa thirrje për drejtësi. Është një deklaratë e fortë e solidaritetit ndërnjerëzor me të mbijetuarat dhe të mbijetuarit, si dhe një kujtim i përhershëm i forcës, guximit dhe rezistencës së tyre në ballafaqim me dhunën". Numri i saktë i personave të dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë, nuk dihet. Sipas një raporti të Qendrës Amerikane për

Kontrollimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, kjo shifër arrin deri në 20 mijë.

Por, sipas të dhënave nga nëntori i vitit të kaluar, vetëm gati 2.000 persona kanë aplikuar për ta marrë statusin e personit të dhunuar gjatë luftës në Kosovë. Prej tyre, statusi u është aprovuar rreth 1.600 personave.

Verifikimi i dëshmimeve të personave që duan ta marrin këtë status - gjatë periudhës nga 27 shkurti i vitit 1998 e deri më 20 qershor të vitit 1999 - bëhet nga Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës në Kosovë.

Osmani ka bërë thirrje që secili kriminel të ballafaqohet me veprat që ka kryer.

"Forca e të mbijetuarve të dhunës seksuale në luftën e Kosovës është burim frymëzimi për të gjithë ne. Ata kanë shfaqur rezistencë dhe vullnet të pasqor për të luftuar për drejtësi, pavarësisht vuajtjeve të jashtëzakonshme".

Ajo ka paralajmëruar se tema kryesore e edicionit të dytë të Forumit Ndërkombëtar për

Gratë, Paqen dhe Sigurinë, do të jetë çështja e dhunës seksuale në kohë lufte.

Ajo ka thënë se më 15 prill në Prishtinë do të mbledhen personalitete nga 40 shtete të botës për diskutuar për fuqizimin e rolit të grave në të gjithë sferat e jetës.

"Përveç trajtimit të pasojave të luftës, ndërtimit të sistemeve për të mbështetur të mbijetuarit, fuqizimin e rolit të grave në proceset e dialogut, në forum do të diskutohet edhe siguria klimatike". Përveç Osmanit, edhe dy gra të Kosovës, të mbijetuara të dhunës seksuale, kanë folur për rëndësinë e mbështetjes së viktimave të dhunës seksuale.

Vasfije Krasaniqi ka rrëfyer për dhunimin që ka përjetuar 25 vjet më parë, dhe lutjet që ua ka bërë forcave serbe që ta vrasin, por që ata nuk kanë pranuar, me arsyetimin se "kështu do të vuash më shumë".

"Fjalja e dytë ishte 'mos i trego askujt çfarë të kemi bërë sepse do të vijmë prapë'".

Shyhrete Sylejmani, e mbijetuara tjetër e dhunës seksuale, ka bërë thirrje që të gjithë të dëgjojnë të



mbijetuarit e luftës dhe të përhapin të vërtetat e tyre.

"Muaji prill i vitit 1999 ndryshoi rrënjësisht jetën time dhe të mijëra të mbijetuarve tjerë. Për 20 vite e kam ndjerë të nevojshme të mbuloj në heshtje të vërtetën e dhimbshme, por të harrosh vuajtjet ka qenë e

vështirë dhe t'i kujtosh ato edhe më rëndë".

Gjatë luftës në Kosovë janë vrarë rreth 13.000 njerëz, ndërsa janë zhdukur rreth 6.000, prej të cilëve rreth 1.600 janë ende të pagjetur. Qindra trupa të shqiptarëve të vrarë të Kosovës janë gjetur në varrezat masive në Serbi.

Hoti: Tri vite nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike, Kosova ende nuk ka ambasador në Izrael

PRISHTINË, 14 PRILL - Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se krerët e shtetit u kujdesën sot të dënojnë sulmet ndaj Izraelit, dhe sipas tij, kjo është me vend. "Këtë e kam bërë edhe vetë në kontaktet e drejtpërdrejta me bartësit e institucioneve izraelite. Por ndihem keq për faktin se tri vite nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike, Kosova ende nuk e ka emëruar ambasadorin/en e Kosovës në Izrael. Kosova ende përfaqësohet në Izrael me 'të ngarkuar me punë'. Kjo është mungesë respekti e krerëve të shtetit të Kosovës ndaj njohjes që na erdhi direkt nga Shtëpia e Bardhë pas



vitesh mungese të njohjeve. Kjo është mungesë respekti ndaj shumë marrëveshjeve që Izraeli ka nënshkruar me Kosovën pas shkëmbimit të misioneve diplomatike në shkurt 2021", ka shkruar Hoti në "Facebook", duke shtuar se: "Këta që më shanin në Kuvend për një marrëveshje të nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë, e hidhnin dyshime për validitetin e kësaj njohjeje që erdhi direkt nga Shtëpia e Bardhë, duhet të tregojnë respekt e mirënjohje për aleatët e Kosovës. Pa ta Kosova mbetet e izoluar, pa zhvillim, pa integritet euro-atlantike".

LDK-ja: Të mbijetuarat e dhunës seksuale, ende përballen me stigmën e mosintegritimit në shoqëri



PRISHTINË, 14 PRILL - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në Ditën e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale në luftën e fundit në Kosovë, ka kujtuar se rrëfimet e grave të përdhunara mbesin të heshtura e të mbushura me dhimbje.

LDK-ja përmes një shënimi në "Facebook" ka theksuar se të mbijetuarat e dhunës seksuale, ende përballen me stigmën e mosintegritimit në shoqëri, edhe pse është bërë një hap për njohjen e statusit të tyre. Dhuna

seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, mbetet plagë e thellë për shoqërinë, si pjesë e një sërë akteve kriminale serbe të kryera në kontekstin e agresionit masiv. "Edhe pas më shumë se dy dekada të përfundimit të luftës, rrëfimet nga gratë mbesin të heshtura e të mbushura me dhimbje. Të mbijetuarat e dhunës seksuale, ende përballen me stigmën e mosintegritimit në shoqëri, edhe pse është bërë një hap për njohjen e statusit të tyre. Heshtja e kësaj teme, është thyer

me guximin e disa të mbijetuarave të cilat kanë ndarë historitë e tyre të dhimbshme publikisht. Si e tillë, ballafaqimi me të kaluarën asnjëherë nuk mund të jetë i drejtë, pa drejtësinë shoqërore ndaj kategorisë së të mbijetuarve. Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, kujdesi rreth mirëqenies së tyre, rehabilitimi dhe risocializimi i tyre qoftë në jetën private apo publike, mbetet obligim", është thënë në një njoftim të LDK-së.



Kurti pret që Kosova të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës

Kryeministri Albin Kurti ka thënë të dielën se pas zbatimit të aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me çështjen e Manastirit të Deçanit, pret që Kosova të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës. “Pas dy ditëve, më 16 prill, do ta kemi votimin më të rëndësishëm deri më sot në këtë proces, me ç’rast Asambleja Parlamentare pritet ta miratojë opinionin e znj. Bakoyannis i cili rekomandon anëtarësimin e plotë të Kosovës, pa asnjë parakusht shtesë dhe pa fusnotë”, ka thënë Kurti, duke shtuar se betejën e radhës e të fundit për këtë proces do ta kemi deri në mesin e muajit maj, kur mbahet ministeriali i Këshillit të Evropës i cili duhet ta ftojë Kosovën që të bëhet anëtarja e 47 e organizatës më të madhe dhe më të vjetër të kontinentin tonë

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 14 PRILL - Kryeministri Albin Kurti në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë se qytetarët janë duke përjetuar progresin e qeverisjes aktuale. Ai ka thënë se tash e tri vjet qytetari e ndjen që qeveria nuk e vjedh atë. “Por qytetari duhet të ndjejë e ta përjetojë edhe drejtësinë t’ia japë hakun. Progresit i nevojitet drejtësia. Drejtësisë i nevojitet progresi. Qeveria progresin, gjyqësori drejtësinë, kështu janë shtyllat e një shteti demokratik ku pushtetet janë të ndara, por nuk mund të kemi qëndrueshmëri nëse secila shtyllë nuk është shtyllë që e mban shtetin për të mirën e shoqërisë”, është shprehur Kurti të dielën. Ai ka thënë se avancimi dhe

progresi brenda vendit është përcjellë njëkohësisht edhe me përmirësimin e imazhit dhe forcimin e sovranitetit jashtë. “Koha kur qytetarët e Kosovës ishin më të izoluarit në Evropë mori fund në janar të këtij viti me liberalizimin e vizave që solli lirinë e lëvizjes dhe forcimin e pasaportës. Nga 1 janari pasaportën e Republikës së Kosovës e njehe Spanja. E liria e lëvizjes vetëm sa shtoi dashurinë për vendlindjen ashtu siç e kishim parashikuar ne pasi tani kemi më shumë qytetarë që kthehen sesa që shkojnë. Mbase, në fund të vizitave, qytetarët po kthehen bashkë me bashkë-familjarët tanë nga mërgata dhe po sjellin edhe vizitorë të huaj, miq të tyre për të shijuar bukuritë e Kosovës e për të parë një shoqëri e kulturë sa të lashtë gjithashtu edhe dinamike në aktualitet”, është shprehur Kurti.

Ai ka theksuar se në maj të vitit 2022 i dhanë fund edhe një periudhë tjetër të izolimit duke aplikuar në Këshill të Evropës, ku, sipas tij, pasi kanë kaluar shumë pengesa kanë ardhur në fund të rrugëtimit për anëtarësim të plotë. “Si kryeministër dhe Qeveri e Republikës së Kosovës, më 13 mars të këtij viti morëm një vendim shumë të vështirë, e megjithatë vazhdojmë të besojmë, të paevitueshëm. Në kuadër anëtarësimi të Kosovës në Këshillin e Evropës, procesi ishte bllokuar nga akterët relevant të Asamblesë Parlamentare të kësaj organizate për shkak se Kosovës i ishin vënë tri parakushte të cilat duhej të plotësoheshin para se procesi të përparonte me tutje. Si rezultat i lobimit intensiv të institucioneve tona, për çfarë në veçanti e falënderoj Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, u arrit që

nga këto tri parakushte, përparimi i procesit të anëtarësimi të sigurohej me vetëm një parakusht: zbatimin e aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me çështjen e Manastirit të Deçanit”, ka deklaruar kryeministri. Ai ka shtuar se sado që kishim të bënim me një vendim të padrejtë e të çuditshëm të Gjykatës Kushtetuese, dakordimi që të mbetej ky parakusht ishte arritur mes raportuesve politikë dhe tri grupeve me të mëdha politike në Asamblenë Parlamentare. “Pra, ishte parakusht i pakompromis dhe i pakthyeshëm. Në anën tjetër, pas shqyrtimeve të gjata e të detajuara juridike u siguroam që ky rast nuk përben precedent dhe dihej tashmë që nuk kishte asnjë mjet legal e juridik për ta kontestuar atë. Sot, gjendemi në një situatë shumë më të favorshme në këtë proces. Raporti dhe opinionin e znj. Bakoyannis njehtësimin e të gjitha parakushteve dhe qartë thotë që zotimet e tjera të Kosovës duhet të përmbushen pas anëtarësimi. Pas dy ditëve, pra pasnesër, më 16 prill, do ta kemi votimin më të rëndësishëm deri më sot në këtë proces, me ç’rast Asambleja Parlamentare pritet ta miratojë opinionin e znj. Bakoyannis i cili rekomandon

anëtarësimin e plotë të Kosovës, pa asnjë parakusht shtesë dhe pa fusnotë”, ka thënë Kurti, duke shtuar se betejën e radhës e të fundit për këtë proces do ta kemi deri në mesin e muajit maj, kur mbahet ministeriali i Këshillit të Evropës i cili duhet ta ftojë Kosovën që të bëhet anëtarja e 47 e organizatës më të madhe dhe më të vjetër të kontinentin tonë. “Këto janë pritjet tona sepse raportet e juristëve eminentë dhe të tri raportuesve politike kanë treguar që Kosova plotëson standardet dhe ka përmbushur parakushtet. Prandaj, nuk ka arsye për hezitim, shtyrje e aq më pak për kundërshtim”, ka thënë Kurti. Ai ka thënë se orientimin strategjik për anëtarësim në Bashkimin Evropian, e zyrtarizuan me dorëzimin zyrtar të aplikimit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, një moment historik për qytetarët dhe shtetin tonë. “Kemi hapur misionin special në Vatikan dhe Poloni, avancuam statusin e Kosovës në nivel të anëtarit të asociuar në Asamblenë Parlamentare të NATO-s dhe u anëtarësuar në shtatë organizata ndërkombëtare: ndër to në Partneritetin për Qeverisje të Hapur (OGP), Komisionin Ndërkombëtar për Personat e

Haziri: Edi Rama ka marrë rol kritik në dialog, kjo ka rëndësi të madhe dhe duhet të gëzohemi

PRISHTINË, 14 PRILL - Nënkrjetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka komentuar zhvillimet e fundit globale por edhe ato që lidhen edhe me dialogun Kosovë-Serbi. Haziri përmes një shënimi në "Facebook" ka thënë se duhet analizuar efektet negative të përplasjeve mes aktorëve global që prekin edhe vendin tonë. "Sulmi i Iranit ndaj Izraelit përbën një situatë të re dhe gjendje lufte. Marrëdhëniet Kinë e Koreja e Veriut po avancohen. Po ndërtohet boshti i të keqes. Lufta në Ukrainë me krejt tragjedinë e saj po vazhdon. Duhet të dënohet por të shihet sa keq po ndikon në Ballkan dhe për ne", ka thënë ai. I dyti i LDK-së ka thënë se duhet t'i gëzohemi faktit që rol në dialog pos treshes evropiane ka marrë edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. "Tashmë formati i dialogut në Ballkanin Perëndimor, ku prioriteti i parë është Kosova dhe Serbia, nuk është vetëm nën kujdesin e treshes së BE-së

Scholz-Macron-Meloni, por edhe kryeministri Rama nga regjioni ynë ka marrë rol kritik. Kjo ka rëndësi të madhe dhe duhet t'i gëzohemi", ka deklaruar Haziri. Ai ka shprehur shqetësimin e tij për mungesën e takimit Kurti - Macron në formatin që i pari i Elizës u takua me Vuçiqin. "Problemi mbetet që takimi i Presidentit Macron me homologun serb ka ndodhur dhe për herë të parë nuk kemi takim të kryeministrit Kurti në këtë format", ka thënë Haziri. Ai ka goditur në mënyrë indirekte Kurtin duke thënë se: "Roli i ShBA-së dhe aleateve është demonstruar me forcë para 25 vitesh. Luftën e kemi fituar por sot paqen e kemi rrezikuar vetë ne. Ata që kanë harruar këtë, le ta shohin një pjesë të saj sot se çka do të thotë miqësi e përhershme me ShBA-të, të cilët e mbrojnë aleatit në çdo kohë dhe me krejt kapacitetet. Koha me pa drejt e krejt çka po ndodhë me Republikën tonë!".



Ushtria serbe afër Bujanovcit, vlerësohet kërcënim ndaj Kosovës



PRISHTINË, 14 PRILL - Kërcënim ndaj Kosovës, e goditje për prishje të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, po konsiderohet prezenca në një numër të madh i ushtrisë Serbe, në Bujanovc. Derisa video ku shihen tanke të ushtrisë janë shpërndarë në rrjete sociale, njohësit e sigurisë kërkojnë reagim të autoriteteve vendore e ndërkombëtare. Qytetarët të cilët kanë shpërndarë këto video, thanë kjo prani ushtarake në kufirin mes Kosovës dhe Serbisë është duke u rritur çdo ditë e më shumë. Për çka edhe ka shkaktuar shqetësim për ta të cilët kanë kërkuar reagimin e autoriteteve në Kosovë dhe të ndërkombëtarëve. E reagimin spektrit ndërkombëtar po e kërkon edhe ish-zëvendësministri i

Punëve të Brendshme, Valdet Hoxha, i cili thotë se Serbia praninë e ushtrisë e arsyeton çdo herë me ushtrime e trajnime. "Prania e ushtrisë serbe në afërsi të Bujanovcit, e kamufluar si trajnim nga Republika e Serbisë, është kërcënim direkt në radhë të parë, ndaj qytetarëve shqiptarë në atë pjesë të vendit, e pastaj edhe kërcënim direkt dhe presion ndaj shtetësisë së Kosovës", ka thënë ai. Që shteti fqinjë i Kosovës, i udhëhequr nga Aleksandar Vuçiq, vazhdimisht kërkon që të godasë stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, e thotë eksperti i sigurisë, Drizan Shala. Ai thotë se një praktikë e tillë e dërgimit të vazhdueshëm të ushtrisë në vijë kufitare, e kishte bërë Rusia para se të niste sulmet në Ukrainë.

Zhdukur (ICMP), Shoqatën Evropiane të Kartës Rinore (EYC) e Institutin Ndërkombëtar të Studimeve Administrative (IIAS)", ka thënë ai. Kryeministri ka deklaruar se këtë muaj ka filluar edhe regjistrimi i popullsisë. Sipas tij, ky proces është një ndërmarrje shumë e rëndësishme institucionale në vendin tonë jo vetëm për të tashmen por edhe për të ardhmen dhe jo vetëm për

të ardhmen afatshkurtër po edhe atë afatmesme e afatgjatë. "Ky regjistrim do të rezultojë me të dhëna të shumta që do t'iu mundësojnë vendimmarrësve dhe shfrytëzuesve të tjerë, duke filluar nga qeveria e shoqëria civile, e deri te bizneset, donatorët e investitorët, të hartojnë politika, zhvillojnë strategji, programe e projekte e produkte, dhe ofrojnë shërbime që i plotësojnë nevojat e qytetarëve. Politikëbërja e bazuar

në të dhëna mundëson shpërndarje të drejtë dhe të barabartë të resurseve për arsim, shëndetësi, banim dhe punësim për të gjithë qytetarët pa dallim dhe komunitetet e vendit tonë", ka thënë ai. Kurti ka shtuar se regjistrimi i popullsisë është ndërmarrje komplekse që kërkon angazhim dhe përkushtim të përbashkët të shtetit dhe tërë shoqërisë, ku të gjithë akterët, duke filluar nga

agjencia e statistikave, niveli qendror e lokal i qeverisjes, mbikëqyrësit, regjistruerit, ekspertët e fushës, mediat, e deri te vet qytetarët - secili e ka rolin dhe rëndësinë e vet në mbarëvajtjen e këtij procesi. "Andaj, të gjithë ne, si qytetarë e si aktivistë, si përfaqësues e si zyrtarë, le ta përkrahim dhe promovojmë këtë proces shumë të rëndësishëm për planifikimin e të ardhmes së vendit tonë. Regjistrimi i

popullsisë është një instrument kyç që përbën mekanizmin nëpërmjet të cilit kuptojmë nevojat dhe gjendjen edhe të pjesëtarëve të diasporës sonë. Kosova për herë të parë ka filluar regjistrimin online të diasporës, në vetëm dy ditë sa është hapur platforma janë regjistruar afër 17 mijë qytetarë. Është koha që të gjithë ne të mobilizohemi për të informuar mërgatën për këtë proces jetik", ka deklaruar Kurti.

Një muaj paraburgim ndaj të dyshuarit për vrasjen e 21-vjeçares në Ferizaj

FERIZAJ, 14 PRILL - Gjykata Themelore në Ferizaj ia ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji të pandehurit, VA, të dyshuar për vrasjen e 21-vjeçares E.C, më 12 prill, si dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të

armës. Më 12 prill, i pandehuri është thënë të ketë plagosur edhe vëllain e viktimës, D.C, 15 vjeç. Në vendimin e Gjykatës, të shtunën, është thënë se i pandehuri ka bashkëjetuar më parë me viktimën, dhe që

ekziston dyshim i bazuar se me vetëdije e ka kryer vrasjen në orët e pasdites së 12 prillit brenda zyrës së Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj. Mediet lokale në Kosovë kanë raportuar se i dyshuari ka qenë ish-bashkëshorti i viktimës dhe

se ata e kanë një fëmijë. Arma e zjarrit është konfiskuar prej Policisë së Kosovës. Zyrtarë të lartë shtetërorë e kanë dënuar ashpër vrasjen dhe kanë bërë thirrje për drejtësi. Nga viti 2010 në Kosovë janë vrarë 56 gra.



Katër muaj nga ngritja e aktakuzës për masakrën e Mejës, ende nuk u publikua në gazetën zyrtare

GJAKOVË, 14 PRILL - Janë bërë katër muaj prej se Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë për masakrën e Mejës, ndaj 53 personave. Por, aktakuza e ftesa, ende nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare ashtu siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale. 370 civilë shqiptarë u vranë e u masakruan, në prillin e vitit të 1999 në fshatin Mejë të Gjakovës.

Për këtë masakër, që është edhe një prej më të rëndave që ka ndodhur në Kosovë gjatë kohës së luftës, Prokuroria Speciale ka ngritur aktakuzë katër muaj më parë.

Si rrallë herë, për ngritjen e kësaj aktakuze, prokurorët dolën edhe në konferencë për medie, duke treguar se akuza është e ndarë në tri pjesë dhe përfshinë gjithsej 53 persona. Por, prej atij njoftimi për ngritjen e kësaj aktakuze që është në mungesë, nuk është ndër-

marr asnjë veprim tjetër.

Nga Prokuroria Speciale e Kosovës tash e një javë nuk kanë kthyer përgjigje, ashtu sikurse nga Gjykata Themelore nuk janë përgjigjur për arsyet e mos publikimit të aktakuzës në Gazetën Zyrtare, për të vazhduar me procesin tutje.

Amer Aliaj, nga Fondi për të Drejtën Humanitare thotë se institucionet duhet të tregohen më efikase dhe të shpejta në rastet e tilla, ndonëse nuk ka ndonjë afat të caktuar. "Çdo aktakuzë për krime të luftës, çdo rast për krimet e luftës duke pasur parasysh edhe koha e cila ka kaluar, pra tani jemi në 25-vjetorin e përfundimit të luftës, aktakuzat e krimeve të luftës duhet të trajtohen me prioritet dhe me një efikasitet të shpejte, për arsye se me kalimin e kohës vdesin personat të cilët kanë bërë krime, vdesin dëshmitarët dhe nuk duhet të humbet kohë, për



shkaqe procedurale, por aty ku ka prova të procedohet", ka thënë ai.

Para se të nisë procesi gjyqësor, gjykata duhet të kërkojë avokat për secilin të akuzuar, derisa në Odën e Avokatëve thonë se ende nuk kanë pranuar një

kërkesë të tillë.

Ata shprehen të gatshëm që të ndihmojnë, që proceset gjyqësore për krime të luftës të përfundojnë në kohë të arsyeshme.

Kompetencat për hetimin e krimeve të luftës, fillimisht

kanë qenë tek UNMIK-u, pas-taj tek misioni i EULEX-it, e që nga viti 2018, hetimi e ndjekja penale bëhen nga Prokuroria Speciale e Kosovës, e cila deri më tash ka ngritur mbi 30 aktakuza.

(TV Dukagjini)

Personalitete botërore në edicionin e dytë të Forumit WPS, të organizuar nga Osmani



PRISHTINË, 14 PRILL - Edicioni i dytë i Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, i organizuar nga presidentja Vjosa Osmani, fillon sot (e hënë).

Ky edicion do të mirëpresë pjesëmarrës nga më shumë se 40 shtete të botës me afro 1 mijë pjesëmarrës, me qëllim të diskutimit dhe bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe paqes.

Ky edicion mbahet në hapësirën e hotelit "Emerald". Ceremonia e hapjes, zhvillohet në ora 10:00.

Për këtë ngjarje, policia ka njoftuar se nga 14 e deri më 17 prill do të ketë bllokime të përkohshme apo riorientim në disa segmente rrugore.

Policia e Kosovës, gjatë kësaj kohe do të kujdeset për ofrim-

in e sigurisë, mirëmbajtjen e rendit e qetësisë publike dhe menaxhimin e trafikut gjatë kohës së lëvizjes së personaliteteve si dhe qëndrimit të tyre në Republikën e Kosovës. Për të mundësuar qarkullim të lirë të delegacioneve sipas itinerarit të lëvizjes si dhe zhvillimin e aktiviteteve, Policia e Kosovës do të bëjë ndërprerje të përkohshme të qarkullimit të trafikut (në intervale të shkurta kohore) të disa segmenteve rrugore (ku pritet të kalojnë personalitetet/delegacionet e ftuara), ku do të ketë riorientim të trafikut në rrugë alternative, andaj Policia e Kosovës kërkon mirëkuptim të plotë nga ana e qytetarëve dhe pjesëmarrësve në trafik.

Hapet Qendra Françeskane për Rini dhe Kulturë pranë Kishës Katolike në Gjakovë

PRISHTINË, 14 PRILL - Të hënë do të fillojnë punimet për lidhjen e Urës së Madhe me rrugën që dërgon deri te rrethi i lagjes "Arbëria". Këtë e ka bërë

me dije nënkryetari i Prishtinës, Alban Zogaj.

Zogaj përmes një postimi në "Facebook", ka thënë se kjo lidhje do të lirojë trafikun në

këtë zonë të qytetit. "Nesër fillojmë punën në një projekt fantastik për Prishtinën! Lidhja e Urës së Madhe me rrugën që dërgon deri tek rrethi i Lagjes

'Arbëria! Kjo lidhje e re do të mundësojë qarkullim alternativ për veturat dhe do të lirojë trafikun në këtë zonë të qytetit", ka shkruar Zogaj.



Kreu i Bordit të ZRRE-së: Elektroserveri po i zbaton ligjet e Kosovës

PRISHTINË, 14 PRILL - Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në Kosovë nuk ka ende informacione se nga cilët operatorë furnizohet Elektroserveri për shpërndarjen e energjisë elektrike në veri të Kosovës, thotë Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZRRE-së, për "Radion Evropa e Lirë".

Megjithatë, kjo kompani, e cila është në pronësi të kompanisë energjetike të Serbisë, EPS, është duke i respektuar ligjet e Kosovës, thekson ai.

Nga qershori i vitit 2022, Elektroserveri ka marrë licencën nga ZRRE-ja për furnizimin me energji elektrike të katër komunave me shumicë serbe në veri - Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zvečan dhe Zubin Potok - dhe për faturimin e qytetarëve atje.

Këta të fundit, që nga paslufta, nuk kanë paguar për rrymën e shpenzuar. Për një kohë, ajo u është faturuar qytetarëve të pjesëve të tjera të Kosovës, e pastaj institucioneve.

Elektroserveri ka filluar shpërndarjen e faturave në veri nga fundi i shkurtit.

I pyetur se sa është numri i konsumatorëve që kanë nënshkruar kontrata për njëhisorë rryme në katër komunat në veri, ai ka theksuar se sipas informatave të para një jave, deri 25% e konsumatorëve kanë pranuar të nënshkruajnë kontrata [me Elektroserverin]. "Kjo përqindje ndryshon çdo ditë, pasi kemi kërkesa të reja për nënshkrim të kontratave", ka thënë Fejzullahu.

Z. Fejzullahu, kompania Elektroserver ka filluar tashmë operimin në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës. A keni informata se nga cilët operatorë energjetikë furnizohet kjo kompani?

Ymer Fejzullahu: Siç e dini, Elektroserveri është licencuar nga ana e ZRRE-së si furnizues komercial dhe, si i tillë, ka të drejtë t'i furnizojë këta konsumatorë përmes çmimeve të tregut me shumicë.

Meqenëse është i derregulluar, kudo që e gjen energjinë ekonomikisht më të favorshme, ai ka të drejtë ta blejë sasinë e



nevojshme dhe t'i furnizojë konsumatorët me çmime të parregulluara.

Për momentin, nuk e di ende se ku furnizohet me shumicë.

Mirëpo, duhet theksuar se Elektroserveri e ka obligim që t'i paguajë tarifën e shfrytëzimit të rrjetit për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës, (KOSTT), dhe për Kompaninë Kosovare për Distribucion të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS).

Ndërsa, tarifën me pakicë që i paguajnë konsumatorët, ai [Elektroserveri], sipas licencës, ka të drejtë t'i përcaktojë me çmime të tregut, apo të propozojë çmime që konsideron se janë të arsyeshme. Por, siç e kemi theksuar edhe në licencë, në rast se kemi çrregullim të tregut të energjisë, ZRRE-ja e ka për obligim të reagojë.

Do të thotë, ZRRE-ja nuk i përcakton tarifën e energjisë elektrike për kompaninë Elektroserver, sikurse për operatorët tjerë energjetikë në

Kosovë?

Ymer Fejzullahu: ZRRE-ja edhe për konsumatorët e veriut i ka përcaktuar tarifën. Ata konsumatorë kanë të drejtë të furnizohen përmes KESCO-s.

Por, ata që furnizohen përmes Elektroserverit, furnizohen me çmime të tregut dhe nuk janë të përcaktuara nga ana e ZRRE-së. Të gjithë konsumatorët në Kosovë, shtëpiakë dhe bizneset - që kanë më pak se 10 milionë euro qarkullim dhe më pak se 50 punëtorë - kanë të drejtë të furnizohen me tarifa të rregulluara nga ana e ZRRE-së; në këtë rast kanë të drejtë të furnizohen me tarifa që janë të përcaktuara për KESCO-n. Sa për informacion, tarifën e propozuar nga Elektroserveri janë përfshirë të përafërta me tarifën e përcaktuar nga ZRRE-ja, edhe si strukturë, edhe si çmim.

Elektroserveri edhe në katër komunat [me shumicë serbe në veri] ka propozuar tarifën me blloqe për konsumatorët shtëpiakë, siç e kemi vendosur

edhe në pjesën tjetër të konsumatorëve.

Sa është numri i konsumatorëve që kanë nënshkruar kontrata për njëhisorë rryme në katër komunat në veri?

Ymer Fejzullahu: Sipas informatave të para një jave, deri 25% e konsumatorëve kanë pranuar të nënshkruajnë kontrata [me Elektroserverin]. Kjo përqindje ndryshon çdo ditë, pasi kemi kërkesa të reja për nënshkrim të kontratave.

A ka ndonjë hezitim të qytetarët për të nënshkruar kontratë, rrjedhimisht për të paguar për energjinë e shpenzuar?

Ymer Fejzullahu: Është e vërtetë se shumë konsumatorë janë duke hezituar, por mendoj se trendi është i kënaqshëm.

Duke pasur parasysh që ata nuk kanë paguar që nga paslufta për energjinë elektrike, është një trend pozitiv, dhe shpresoj që brenda një periudhe të shkurtër, edhe konsumatorë të tjerë të

nënshkruajnë kontrata me Elektroserverin.

Është ende një periudhë e shkurtër e operimit të Elektroserverit në veri të Kosovës, por, gjatë kësaj kohe, a janë respektuar ligjet e Kosovës, ashtu siç parasheh licencën e lëshuar nga institucioni që udhëhiqni ju?

Ymer Fejzullahu: Deri më tash, Elektroserveri i ka nënshkruar të gjitha kontratat sipas legjislacionit në fuqi me KOSTT-in dhe KEDS-in. Përafërsisht janë tri-katër kontrata me KOSTT-in dhe dy marrëveshje me KEDS-in dhe ato i ka respektuar.

E ka dorëzuar për rishikim në ZRRE edhe draft-kontratën që lidhet me konsumatorët. Ne e kemi dhënë një lloj pëlqimi, konfirmimi, se kjo kontratë i përmban të gjitha dispozitat sipas legjislacionit në fuqi. Nuk e kemi obligim aprovimin e kontratave me furnizues komercialë, mirëpo e monitorojmë se a u përmbahet të gjitha dispozitave sipas legjislacionit në fuqi.

Parandalohet kontrabanda e cigareve në Han të Elezit, vlera e mallit 3 000 euro

PRISHTINË, 14 PRILL - Njësitë e Doganës në kuadër të pikës kontrolluese kufitare në Han të Elezit, kanë arritur të parandalojnë tentim kontrabandimit të cigareve. Në njoftimin e bërë për medie thuhet se rreth orës 09:00, të dielën, në Han të Elezit, një kamion me targa kosovare është ndaluar për kontroll dhe gjatë kontrollit fillestar të kabinës së

shoferit, zyrtari doganor ka zbuluar 30 boksa cigare derisa më pastaj janë kryer kontrollet më mëtejshme në terminalin doganor, ku janë gjetur edhe 70 boksa cigare të fshehura në kabinën e kamionit.

Vlera e kësaj sasive është rreth 3000 mijë euro.

Dogana ka bërë me dije se mallrat janë konfiskuar si dhe ka filluar procedura

kundërvajtëse. Dogana e Kosovës ka aplikacionin eDogana për pajisjet e mençura Android dhe Ios, i cili mundëson lajmërim të parregullsisë dhe sjelljeve jo profesionale me komunikim të sigurt dhe gjithashtu ofron shërbime tjera me qëllim të shërbimit ndaj qytetarëve dhe komunitetit të prodhuesve dhe tregtisë në përgjithësi.



Analiza e CNN: Sulmi i Iranit, i planifikuar për të minimizuar viktimat dhe maksimizuar spektaklin



Tamara Qiblawi - CNN

Një luftë në hije prej dekadash shpërtheu hapur brenda natës, ndërsa dronët dhe raketat iraniane ndriçuan qiellin në Izrael dhe Bregun Perëndimor. Operacioni i Teheranit ishte shumë koreografik, me sa duket i projektuar për të minimizuar viktimat duke maksimizuar spektaklin.

Ky ishte një mision kompleks. Mbi 200 dronë dhe raketa fluturuan mbi fqinjët e Iranit, duke përfshirë Jordaninë dhe Irakun, të dyja me baza ushtarake amerikane, përpara se të depërtonin në hapësirën ajrore të armikut të Iranit, Izraelit. Aleatët e Izraelit ndihmuan në rrëzimin e pjesës më të madhe të këtyre dronëve, por nuk mundën të parandalonin atë që besohej prej kohësh të ishte skenari i fundit i botës në Lindjen e Mesme, sulmi i parë i Republikës Islamike ndaj Izraelit.

Sistemi i mbrojtjes ajrore 'Iron Dome' i Izraelit nuk i zhgënjeu izraelitët. Vetëm një pjesë e vogël e vendndodhjeve u sulmuan, duke përfshirë një bazë ushtarake dhe një zonë në shkretëtirën Negev, duke plagosur një fëmijë beduin, ndërsa kupola shmangi një nga sulmet më të mëdha me dron në histori.

Megjithatë, ishte një operacion që dukej i projektuar për të dështuar, kur Irani nisi dronët e tij vrasës nga territori i tij rreth 1000 milje larg, ai po i jepte Izraelit disa orë paralajmërim. Por simbolika e sulmit ishte e rëndë. Në vend të zjarrit nga një nga vendet fqinje ku Irani dhe aleatët e tij joshetërorë janë të pranishëm, ky ishte një sulm i drejtpërdrejtë nga territori iranian në territorin izraelit. Kjo kompromentoi aftësinë e Iranit për të dëmtuar Izraelin, sepse ai ia hoqi operacionit elementin e befasisë.

Megjithatë, për rreth katër orë, bota mbajti frymën ndërsa armët vërshuan nëpër qiell. Ata ishin topa zjarri që fluturonin sipër, ndërsa shikuesit nëpër tre vende të ndryshme filmonin imazhe që dukej se parashikonin fillimin e një lufte kataklizmike. Koha e udhëheqjes nënkuptonte që Izraeli dhe partnerët e tij rajonalë mund të përgatishnin mbrojtjen e Izraelit dhe operacioni ishte pak më shumë se një shfaqje e frikshme fishekzjarresh. Kur misioni i përhershëm i Iranit në Kombet e Bashkuara postoi në Twitter se operacioni kishte "përfunduar", ishte e lehtë të mendoje se Republika Islamike vetëm leh dhe nuk kafshon.

Sulmi shërbeu si një hakmarrje ndaj sulmeve ajrore izraelite në konsullatën e Iranit në Damask në fillim të prillit që vrau një

komandant të lartë dhe ishte në përputhje me pritshmëritë e inteligjencës dhe analistëve amerikanë. Udhëheqja e Iranit u ndje dhe detyruar të godiste Izraelin në mënyrë që të përsëriste pozicionin e tij si një fuqi rajonale dhe të shpërndante nocionet e tij. Ajo e dyfishoi shfaqjen e saj të forcës duke nisur operacionin nga territori i saj dhe jo me prokurë në Siri, Liban, Jemen apo Irak.

Megjithatë, Irani gjithashtu duhej të përpiqej të shmange ndezjen e një lufte gjithëpërfshirëse. Ekonomia e saj është përkulur nën peshën e sanksioneve të epokës Trump dhe ka pakënaqësi në rritje në rrugët e saj për politikën represive të qeverisë. Të dielën, Irani u duk se jo vetëm se kishte marrë parasysh sistemet e fuqishme të mbrojtjes ajrore të Izraelit, por se ishte mbështetur në të. Shkalla relativisht e lartë e inteligjencës amerikane në lidhje me operacionin sugjeron gjithashtu se Irani mund të jetë përfshirë në kanalizime me liderët perëndimorë. Ministri i Jashtëm iranian Hossein Amir Abdollahian tha se ai u dha vendeve fqinje, përfshirë aleatët kryesorë të SHBA-së, 72 orë njoftim. Për të frenuar pasojat e operacionit të tyre, ata u duk se synonin ta pengonin atë.

Stili i sulmit të kujton përgjigjen e Teheranit ndaj vrasjes nga ish-presidenti Donald Trump të gjeneralit më të njohur të Iranit,

Qassem Soleimani, në janar 2020. Teherani u dha trupave amerikane 10 orë paralajmërim paraprak përpara se të hidhte raketa masive balistike mbi pozicionet ushtarake amerikane në Irak, duke përfshirë bazën ajrore al-Asad. Sulmi shkaktoi dëme, duke lënë kraterë të hapura në tokë, por nuk shkaktoi viktimat e njohura në SHBA. Në këtë proces, forcat iraniane rrëzuan aksidentalisht një avion komercial që u ngrit nga aeroporti i Teheranit, duke vrarë mbi 100 pasagjerë dhe duke nxitur zemërimin e publikut kundër një regjimi që shihet gjithnjë e më shumë si i paaftë. Në atë kohë, iranianët ishin të shqetësuar me demonstrimin e asaj që ushtria e tyre mund të bënte, në vend të asaj që ishte e gatshme të bënte. SHBA nuk u kundërpërgjigj, duke shmangur luftën rajonale.

Katër vjet më vonë, libri i lojërave të Iranit mund të mos shpaloset në të njëjtën mënyrë. Izraeli tashmë është zotuar të përgjigjet. SHBA ka deklaruar publikisht se nuk do të marrë pjesë në një hakmarrje izraelite, gjë që mund të qetësojë Iranin. Megjithatë, Izraeli i Netanyahu është dëshmuar gjithnjë e më i paparashikueshëm. Kërcënimet e Iranit për veprime më të rënda në rast të përshkallëzimit të mëtejshëm mund të bien në vesh të shurdhër në Izrael.

Në një sulm të ardhshëm të

Iranit, Teherani mund të mos hezitohet të përdorë kufirin verior të Izraelit si një pikë lëshimi. Një javë përpara sulmit, një burim libanez i njohur me këtë çështje kishte përjashtuar që Hezbollahu, partneri më i fuqishëm i grupit të armatosur të Iranit, do të ishte pjesë e hakmarrjes fillestare të Iranit ndaj sulmit të konsullatës së 1 prillit.

Megjithatë, burimi paralajmëroi se Hezbollahu dhe forcat e tjera luftarake të mbështetura nga Irani "do të përgatiten për fazën që vjen pas përgjigjes iraniane". Një hakmarrje e fuqishme izraelite mund ta shtyjë Iranin të marrë një pozicion edhe më të ashpër përtej politikës së tij izraelite. Konservatorët kanë konsoliduar kontrollin e qeverisë së Iranit në vitet e fundit dhe ka një rezistencë në rritje ndaj presionit perëndimor për të frenuar programin e frikshëm të pasurimit të uraniumit të vendit. "Duhet të ketë njëfarë kënaqësie në qarqe të caktuara në DC dhe Izrael që përgjigja e kufizuar e Iranit pasqyron çekuilibrin e fuqisë në favor të Izraelit," shkroi Trita Parsi, analiste iraniane me bazë në DC dhe Zëvendës Presidente Ekzekutive e Institutit Quincy, në X.

"Por mendoni më tej dhe do të kuptoni se si ky episod do të forcojë ata në Teheran që besojnë se Irani duhet të bëhet bërthamor."

DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (18)



Prof. dr. Sabit SYLA &
Prof. dr. Hamit KABA

-102-

Gazeta 'The Economist'
Ftitil shpërthyes në Ballkan

Një koncesion për Kosovën sot mund t'i kursejë Jugosllavisë një shpërthim më të madh nesër

2 tetor 1981

Vazhdoni të vëzhgoni Poloninë; por gjithashtu hidhini një sy të kujdesshëm një zone të quajtur Kosovë, në pjesën tjetër fundore të Evropës komuniste. Kosova është pjesë e Jugosllavisë ku jeton pakica e saj shqiptare, në skaj të Shqipërisë. Gjatë muajve të fundit rreth 300 nga këta shqiptarë (prej popullsisë së përgjithshme të Kosovës që nuk është më e madhe se ajo e Detroitit apo më e vogël se ajo e Liverpool) janë dënuar me burgim që shkon deri në 15 vjet për "aktivitet kundërrivolucionar" – një fjalë e përbërë që nënkupton çdo gjë nga vjedhja e armëve deri tek shkrimi i parullave në mure.

Qeveria jugosllave pretendon se janë planifikuar masa të rrepta për të mbrojtur Jugosllavinë nga "armiku" që bën "luftë të veçantë" nga qendrat jashtë vendit. Kjo nuk ka kuptim. Të mërguarit jugosllavë në Perëndim, të cilët nuk e pëlqejnë qeverinë e Beogradit janë shumë të dobët dhe të përçarë për të qenë një kërcënim serioz për regjimin jugosllav, dhe nuk kanë ndihmën e qeverisë perëndimore. Bashkimi Sovjetik, i cili mund të ketë interes për destabilizimin e Jugosllavisë, është shumë i zënë për momentin me Poloninë dhe Afganistanin; nuk ka të dhëna se ka organizuar trazirat në Kosovë.

Qeveria jugosllave në Kosovë përballat me një kërkesë krejtësisht të zakonshme për autonomi lokale të një lloji të ngjashëm me Spanjën, Italinë, Francën dhe shumë vende të tjera. Pranverën e kaluar demonstrata të përhapura në Kosovë bënë thirrje që krahinës t'i jepej statusi i plotë i Republikës së Federatës jugosllave (aktualisht, Kosova është zyrtarisht nën/ndarje e Jugosllavisë).

Qeveria federale dërgoi atje një numër të madh trupash dhe policësh për të shtypur këtë kërkesë, duke argumentuar se nëse Kosova do të bëhej Republikë, ajo do të shpërthente krejtësisht nga Jugosllavia dhe do të bashkohej me Shqipërinë. Askush nuk mund t'i kërkojë Jugosllavisë të japë sinjalin fillestar për shpërbërjen e saj. Por edhe ky pretendim është ndoshta i pakuptimtë. Shqiptarët e Kosovës nuk po kërkojnë të bashkohen me

Shqipërinë; Shqipëria thotë se nuk po kërkon që t'i pranojë ata.

Pse jo?

Argumenti se Kosova duhet të jetë anëtar me të drejta të plota i Federatës jugosllave, duket mjaft bindës. Popullsia e Kosovës është pothuajse tre herë më e madhe se ajo e Malit të Zi fqinj, i cili ka statusin e plotë të Republikës. Popullsia e Kosovës është pak më e vogël se ajo e Maqedonisë apo Sllovenisë, të cilat janë gjithashtu Republika. Më shumë se tre të katërtat e popullsisë prej 1.6 milion të Kosovës janë shqiptarë etnikë (grupi tjetër më i madh, serbët, përbëjnë vetëm 13.2%). Në të kaluarën qeveria federale në Beograd dukej dashamirëse ndaj shumicës së Kosovës; gjatë dekadës së fundit, kjo zonë ka pasur diçka të afërt me statusin e Republikës. Masat e rrepta aktuale janë një ndryshim i liberalizimit të mëparshëm jugosllav.

Gjithashtu, kjo situatë nuk duket se po funksionon. Pas disa muaj gjyqesh, pushimesh nga shkolla dhe puna, si dhe spastrimesh të qeverisjes dhe Partisë komuniste në nivel lokal, përsëri shfaqen parulla në mure, qarkullojnë fletushka dhe vazhdon sabotimi. Politika e retë kritikosh tjetërkund në vend. Z. Mitja Ribiqiq, ish Kryeministër i Jugosllavisë, tha muajin e kaluar se kapja e 18-vjeçarëve i bëri ata heronj.

Jugosllavia pretendonte se ishte vendi më fleksibil dhe mendjehapur i vendeve komuniste (deri kur sindikata Solidariteti filloi t'i ndryshonte faqen Polonisë). Për qeverinë jugosllave të thuash Jo, asnjëherë përpara një kërkesë në dukje të arsyeshme të një pakice me kujtime të gjalla të shtypjes në të kaluarën, bie në kundërshtim me këtë pretendim. Italia e ka zgjidhur pak a shumë problemin e pakicës së saj veri-lindore gjermane, duke i dhënë krahinës Aldo Adige një shkallë të kënaqshme autonomie. Spanja i ka bërë një ofertë të ngjashme pakicës së saj baske. Jugosllavia ka probleme të mëdha ekonomike dhe politike, që shkojnë përtej mosmarrëveshjeve me Kosovën.

Një periudhë e gjatë represioni dhe rezistence në Kosovë mund të ishte fitili që shkakton një shpërthim më të gjerë. A nuk do të ishte më mirë për Jugosllavinë që t'i lejonte kosovarët të kenë po ashtu Republikë, të cilën duket se e dëshiron shumica?

-103-

Për përdorim të kufizuar

Z. Gray (EESD)

8 tetor 1981

Kosova: problemet ekonomike

1. Letra e Z. Crawford e datës 8 shtator na kujton fuqimisht se Jugosllavia është një vend në zhvillim. Problemet e shkaktuara nga një popullsi e re, rritje e shpejtë e krahut të punës, nën-punësimi dhe papunësia, shpërnguljet

ekonomike dhe aftësia e ekonomisë për t'i kushtuar burime shtesë shpenzimeve të zhvillimit, nuk është promovuar as nga mosdashja e Jugosllavisë për të përdorur me efektivitet sistemin e tregut as nga mos dëshira, e as nga paafhtësia e tyre për të planifikuar me efektivitet. Problemet e Kosovës ka të ngjarë të thellohen nëse nuk do të ketë një vlerësim më të gjerë të nevojës për të ndryshuar politikën ekonomike në nivel federativ dhe krahinor (dhe për t'i harmonizuar të dyja këto nivele). Natyrisht, këtu qëndron problemi. Interesat federale dhe krahinore do të ndahen me raste dhe një gjë e tillë do të pasqyrohet në këndvështrimet e autoriteteve të ndryshme. Jam shumë i interesuar për ndonjë studim që Zoti Crawford mund të bëjë mbi ndarjen e pikëpamjeve të autoriteteve federative dhe krahinore dhe mbi dallimet midis këndvështrimeve krahinore.

M. Williamson
ESID

-104-

Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
Ambasada Britanike
Beograd
13 tetor 1981
Londër SW1A 2AH
C. G. Crawford Esq
Inderuar Charles,

Kosova: problemet ekonomike

1. Jemi të interesuar të lexojmë shkresën tuaj të datës 8 shtator drejtuar Charles Gray për problemet ekonomike që aktualisht po përballon Kosova (8 shtator).

2. Përshkrimi juaj i problemeve ekonomike në nivel krahinor duket se në shumë mënyra pasqyron në njëjtat probleme të përjetuara nga Jugosllavia në nivel Federal. Këto janë probleme të rritjes së shpejtë të fuqisë punëtore, shpërnguljes rurale-urbane dhe studentëve të mirë-arsimuar, të cilët kanë perspektiva

të dobëta punësimi. Shkurtimisht, këto janë probleme të një vendi në zhvillim.

3. Çështja që na intereson veçanërisht është se në çfarë mase janë në harmoni autoritetet Federative dhe krahinore në politikën e tyre ekonomike dhe në çfarë mase janë në harmoni krahinat dhe republikat me njëra tjetrën. Ju vetë bëtet këto pyetje: 'A mundet Jugosllavia që ekonomisht të vazhdojë të përballojë mbështetjen për Kosovën? A mundet që politikisht të mos e përballojë një gjë të tillë?' Kjo situatë sugjeron se jo larg mund të ketë tensione të mëtejshme midis Beogradit dhe Prishtinës, dhe se krahina të tjera mund të fillojnë të ndjejnë tensionin ekonomik në mënyrë më akute dhe të ndryshojnë në qasjen e tyre ndaj problemeve. Jemi shumë të interesuar për çdo gjë që do të bëni për këtë temë.

4. Përmes një komenti të hollësishëm, bashkëngjitur po ju dërgoj një përkujtesë të Martin Williamson për shkresën tuaj.

I Juaji

T. C. Moore

PS. Lejomëni të prezantohem. Jam emëruar për të zëvendësuar Jon Ward vitin tjetër dhe aktualisht po fitoj përvojë në zyrën jugosllave në EESD me Charles Gray para se të mësoj gjuhën serbo-kroate. Shpresoj se do i shkruaj Jon-it së shpejti.

-105-

Për përdorim të kufizuar

Z. Gray, EESD

Për dijeni: Z. Poston, ECD(I)

Z. Dun)

UKREP Bruksel)

Z. Marsden)

Protesta e Jugosllavisë për rezolutat e parlamentit evropian mbi çështjen e Kosovës

1. Z. Clark në Beograd telefoni këtë pasdite për të thënë që përfaqësuesi i Komisionit është thirrur sot në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë për të



marrë një protestë të fortë verbale për Rezolutat që po shqyrtohen aktualisht nga Parlamenti Evropian mbi situatën në Kosovë. Përfaqësuesi i Komisionit (M. De Lange) ishte përgjigjur se protesta të tilla duhen bërë para Kryesisë dhe jo para Komisionit. Për këtë arsye, Z. Clark kërkon udhëzime të menjëhershme në rast se Ambasada e Madhërisë së Saj do të thirret nga ana e tyre.

2. I thashë Z. Clark se nëse do të thirret linja e tij, duhet të jetë (përveç marrjes së shënimeve dhe marrjes përsipër për të raportuar) si më poshtë:

a) Qeveria e Madhërisë së Saj nuk komenton formalisht mbi Rezolutat e Parlamentit Evropian; b) Qeveria e Madhërisë së Saj nuk ka fuqi apo influencë mbi Parlamentin;

c) Parlamenti është organ i pavarur që ka funksionin këshillimor: ai nuk ka tagrin të diktojë politikën e Komunitetit; d) Jugosllavët duhet të bëjnë të njohura në mënyrë të drejtpërdrejtë pikëpamjet e tyre para Parlamentit nëse dëshirojnë të ndikojnë në shqyrtimet e tij;

3. Natyrisht që do të kemi të reja të tjera në këtë çështje. Do të isha mirënjohës nëse Z. Poston do të më dërgojë sa më shpejt kopje të Rezolutave përkatëse.

J. A. Dew

Komuniteti Evropian
13 tetor 1981

(Departamenti i Jashtëm)

-106-

Për përdorim të kufizuar

A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Beograd
14 tetor 1981
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtëm dhe e Komonuelthit
Inderuar Alan,

Kosova: situata politike dhe e sigurisë

1. Charles Crawford ka bërë një pasqyrë të zhvillimeve të fundit në Kosovë në letërën e tij të datës 30 shtator. Që atëherë, Lazar Mojsov, Kryetar i Kryesisë së LKJ, dhe Tihomir Vlashkcaliq, Kryetar i Komitetit Qendror Serb, vizituan krahinën më 8/9 tetor për ta parë vetë situatën.

2. Vizitorët biseduan me përfaqësues të Universitetit të Prishtinës, vizituan një fabrikë në Prizren, udhëtuan në një komunë etnikisht të përzier afër Gjakovës dhe përfunduan me bisedime në Komitetin Krahinor në Prishtinë. Media i bëri një pasqyrë të plotë, por jo të spikatur udhëtimit dhe Mojsov e përdori këtë në favor të vet, veçanërisht në një intervistë në televizion, për të treguar veten e tij si një politikan i vendosur, kompetent dhe i ndjeshëm. Në të vërtetë, ky rast mund të ketë qenë një nga objektivat e tij, pasi koha e qëndrimit të tij në detyrë është gati në përfundim dhe ndoshta kjo ishte mundësia e tij e fundit që të shkëlqente para se t'i kthehej anonimitetit relativ të Kryesisë. Nëse, siç thuhet, ai ka pretendime të pasojë Vrhovecin pranverën e ardhshme, përfundimi i mandatit

me përparimin e një burri shteti në Kosovë, nuk do t'i sillte asgjë të keqe atij.

3. Megjithatë, objektivat e tij kryesore duket se kanë qenë të dyfishta: së pari, të ripohonte se LKJ kishte vendosmërinë dhe durimin për t'u marrë me opozitën nacionaliste; dhe, së dyti, të merrte disa përshtypje të para për "platformën" afat-gjatë mbi zhvillimin e mëtejshëm të Kosovës, për të cilën ai zbuloi se po përgatitej në Komitetin Qendror. Në pikën e parë, ai e pranonte se, megjithëse situata politike ishte stabilizuar gjithnjë e më shumë, armiku ishte ende aktiv dhe ekzistonin ende ata që "luanin në fshetësi". Ai u bëri thirrje njerëzve të bënin të qartë qëndrimin e tyre, me sistemin aktual apo kundër tij, në mënyrë që armiku të mund të identifikohet qartazi. Së dyti, ai tha se kishte krijuar përshtypje të leverdishme për disa ndryshime në situatën politike të Krahinës por konkludoi se LKJ-së i nevojitej të ndërmerre një aksion më të gjerë ideo-politik, për të cilin "platforma" do të shërbente për të mobilizuar forcat subjektive socialiste aty.

4. Për ko incidencë, Këshilli Ekzekutiv i Kosovës pranoi më 10 tetor shqyrtimin e pritur të draftit të Planit 5-Vjeçar për Krahinën. Megjithatë, ky dokument nuk është miratuar ende, por tani do të dalë për diskutim publik. Duket sikur ky Plan nuk do të finalizohet para fundit të vitit. Sidoqoftë, Plani është në shqyrtim dhe shenjat janë se do të nxirret më me realizëm se planet pararendëse.

5. Përfundimisht, ende nuk kemi dëgjuar lajmin e fundit për përgjegjësinë personale të Bakallit mbi ngjarjet në Kosovë. E përjavshmja "Komunist", jo më pak, përmban një letër të lexuesit ku pohon se ai dhe publiku në përgjithësi, nuk e mendonin se, duke pasur parasysh një sërë mosveprimesh dhe dështimesh të renditura, në cilat komisioni i hetimit ia ngarkoi Bakallit, thjesht mjaftonte që ai të përjashtohet nga Komiteti Krahinor dhe të lihej i lirë me një paralajmërim të fundit para se të përjashtohet nga LKJ. Dyshoj nëse LKJ ishte e prirë për të çuar Bakallin në gjyq, pasi shumë të tjerë gjithashtu mund të implikoheshin, por letra mund të jetë një balonë prove për të testuar reagimin në Parti.

6. Kështu, ngadalë dhe në mënyrë

të pashmangshme, vazhdon procesi i grumbullimit të copëzave në Kosovë. Fakti që pas gjashtë muajsh armiku mbetet i pakapshëm dhe aktiv, tregon se sa i vështirë është problemi themelor i nacionalizmit shqiptar.

I Juaji
T. J. Clark
Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit
FCO

-107- Zyra e Jashtëm dhe e Komonuelthit

Beograd
16 tetor 1981
Londër SW1A 2AH
Charles Crawford Esq
Inderuar Charles,

Raportimet e fundit për Kosovën

1. Kemi marrë raportet e juaja më të fundit mbi situatën në Kosovë dhe do të doja t'ju falënderoj për vazhdimin e raportimit të hollësishëm dhe interesant pas ngjarjeve për këtë temë.

2. Letrat e juaja drejtuar Charles Gray për Mahmut Bakallin (29 shtator) dhe aspektet e përgjithshme politike të Kosovës (30 shtator) ilustrojnë mjaft qartë faktin se demonstratat nuk shpërthyen papritmas. Shkrimet kanë qenë për një kohë të gjatë nëpër mure për udhëheqjen krahinore dhe vetëm udhëheqja qendrore mund të pretendojë sot se është befasuar nga shpërthimi i trazirave.

3. Është bërë tashmë e ditur zyrtarisht përgjegjësia e Mahmut Bakallit për përpjekjet e tij që të kalojë në heshtje protestat e mëparshme të kosovarëve. Duket se pak vëmendje i është kushtuar kërkesave politike dhe motiveve të protestuesve. Kjo tendencë nuk duket se është kapërcyer plotësisht që prej trazirave kryesore. Në dritën e kësaj situatë, veçanërisht interesant ishte koment i juaj për mungesën e analizës së hollësishme serioze politike të 'Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste të Shqiptarëve' (PKMLSH). Thirrja e komisionit hetues për një betejë 'të hapur' kundër nacionalizmit pa dyshim që do të mirëpritet nga shtypi.

4. Mund të dëshironi të dini se Ambasadori jugosllav në Londër është ankuar tek Lord Trefgarne në një pritje, mbi artikullin për Kosovën në gazetën 'The

Economist' (3 tetor). Komentet se politika jugosllave është 'marrëzi' mund ta kenë nxehur atë, por mund të ketë qenë edhe fakti se thirrja që Kosova të bëhet Republikë, ka shkaktuar reagime. Pa dyshim ky është një shembull tjetër i shkallës së ndjeshmërisë që jugosllavët kanë për problemet e kombësisë.

I Juaji
T. C. Moore
Departamenti Sovjetik & i Evropës Lindore

-108- Konfidenciale

Zyra e Jashtëm dhe e Komonuelthit
Ambasada Britanike
Beograd
21 tetor 1981
Londër SW1A 2AH
D I Miller Esq
Inderuar David,

Jugosllavia, Bullgaria dhe Shqipëria

1. Jam i interesuar për të lexuar letrën tuaj të datës 14 tetor mbi simetrimin që po ruan Jugosllavia në akuzat e saj për pretendimet e supozuara shqiptare dhe bullgare ndaj territorit jugosllav - megjithëse nuk jam realisht i bindur për justifikimin e secilës akuzë.

2. Referenca juaj për ndjeshmërinë ekstreme aktuale të jugosllavëve ndaj çdo forme të propagandës që mund të prekë integritetin e Federatës është ilustruar gjerësisht këtu përmes bujës që bën Stamenkoviç për kryeartikullin mbi Kosovën në gazetën 'The Economist' të datës 2 tetor (kopja bashkëngjitur në rast se nuk e keni lexuar atë). Kjo sugjeronte, ndër të tjera, se do të ishte më mirë që Jugosllavia të lejonte kosovarët të ishin edhe ata Republikë siç duket se dëshironte shumica. Stamenkoviç shpenzoi 25 minuta nga vizita e shkurtër prezantuese prej 30 minutash për Lordin Trefgarne javën e kaluar, duke kërkuar sigurinë që një gjë e tillë nuk pasqyrore politikën e Qeverisë së Madhërisë së Saj. Këtë ai natyrisht e shoqëroi - në mënyrë të përsëritur dhe me forcë - me sigurinë se pavarësisht sa gabim mendonim për artikuj të tillë, ne nuk kishim fuqi për të bërë ndonjë gjë për ta. Megjithatë, gjatë largimit Stamenkoviç më shprehu mendimin e tij se mund të jetë

marrë shumë me këtë çështje. U përgjigja në mënyrë të paqartë, por nuk shpreha mospajtim me atë që tha.

3. Një shembull tjetër u ofrua nga Komisioni i Lartë Kanadez këtu, i cili më njoftoi se gjatë vizitës së Lamontagne, Ministri i Veteranëve të Kanadasë javën e kaluar në Jugosllavi, Ljubiçiq u ankua ashpër për artikullin dhe sugjeroi se ishte frëmëzuar nga Qeveria britanike. Ljubiçiq kishte pyetur më tej se 'nëse Qeveria britanike ishte kaq e zgjuar, pse nuk e kishte zgjidhur problemin në Irlandën e Veriut?' E kuptoj se Lamontagne ndjehej i kënaqur duke mbrojtur pavarësinë e medias Perëndimore (Ky informacion më është dhënë në konfidencë: do të isha shumë mirënjohës nëse nuk do të njoftoni Ambasadën Kanadeze në Beograd se jeni në dijeni të kësaj).

J C R Gray
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore

Për dijeni:
Departamenti i Lajmeve
Departamenti i Kërkimit

-109-

Për përdorim të kufizuar

T Moore Esq
Ambasada britanike
EESDBeograd
FCO, 21 tetor 1981
Inderuar Trevor,

Kosova: artikulli i gazetës "The Economist"

1. Ju falënderoj, për letrën tuaj të datës 16 tetor. Në lidhje me ankesën e Ambasadorit jugosllav drejtuar Lord Trefgarne mbi artikullin për Kosovën në gazetën "The Economist" (paragrafi 4), duhet të viheni në dijeni se Ambasadorit i është thënë nga Ambasadori kanadez se Ministri i Mbrojtjes së Jugosllavisë, Gjeneral Ljubiçiq, ia kishte përmendur artikullin Ministrin të Mbrojtjes së Kanadasë gjatë vizitës së tij të fundit këtu. Gjeneral Ljubiçiq ka thënë se kërkesa "Kosova-Republikë" ishte e papranueshme pasi nënkuptonte shpërbërjen e tri Republikave të Jugosllavisë dhe do të kishte tendencën të krijonte mungesë stabiliteti në Ballkan.

2. Sidoqoftë, çështja nuk është shtruar para nesh; ndoshta kanë vendosur që vetëm të regjistronë një ankesë në Londër. Por kjo tregon se artikuj të tillë janë lexuar dhe analizuar në nivelet më të larta këtu.

I Juaji
Charles Crawford
Oficer Informacioni

-110- Konfidenciale

FM Beograd ZLGR4732
23 tetor '81

Situata e brendshme në Jugosllavi-Kosovë

1. Përmbledhje: Ngjarjet e pranverës së kaluar vazhdojnë të hedhin dritë mbi problemet e krahinës, marrëdhëniet Beograd-Kosovë dhe Jugosllavi-Shqipëri. 232 persona janë arrestuar për trazirat në Kosovë. Vazhdojnë të shfaqen parulla armiqësore dhe,



po kështu, vazhdon largimi i jo-shqiptarëve nga Kosova. Ndërkohë, ende nuk është zgjidhur se si të trajtohen shkaqet themelore të problemeve dhe ky është preokupim i Partisë dhe autoriteteve Federative, atyre të Serbisë dhe Kosovës në të gjitha nivelet. Gjithsesi, qeveria Federative nuk është e përgatitur madje as që do të shqyrtojë aspiratat e Kosovës për statusin e Republikës. Shqipëria vazhdon të sulmojë Jugosllavinë për represion në Kosovë.

2. 232 individë, shumica e tyre studentë dhe mësues, janë dënuar për periudha që shkojnë deri në 15 vjet në lidhje me trazirat e periudhës së marsit-majit të kaluar. Mësuesit janë akuzuar se kanë abuzuar me pozicionin e tyre për të indoktrinuar "mijëra" të rinj etnikë shqiptarë me ideologjinë nacionaliste. Akuzat për të cilat të dënuarit janë akuzuar përfshinin vënie në rrezik të sistemit socialist jugosllav; përpjekjet për të shkelur integritetin territorial të Jugosllavisë, përhapjen e propagandës armiqësore dhe nxitjen e urrejtjes kombëtare. Dy organizata krahinore, "Lëvizja për Çlirimin e Kosovës" dhe "Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi" thuhej se kanë bashkëpunuar për organizimin e demonstratave dhe ngritjen e rrjetit të komiteteve lokale. Gjithashtu është pretenduar se në radhët e anëtarëve të këtyre organizatave janë zbuluar edhe agjentë të shërbimit të fshehtë shqiptar.

3. Megjithëse situata në Kosovë duket se është stabilizuar, vazhdojnë të shfaqen parulla armiqësore. Popullsia serbe dhe ajo malazeze vazhdon të jetë ende subjekt i ngacmimeve, me sa duket me qëllim për t'i bindur që të largohen. Ata vazhdojnë të veprojnë në këtë mënyrë megjithëse, pa dyshim, një faktor më vete është gjithashtu edhe situata ekonomike.

4. Dënimet e rënda përbëjnë një pranim të heshtur të masës me të cilën ndjenja nacionaliste përshkon popullsinë e Kosovës. Çështja se si do të trajtohen shkaqet kryesore të këtij problemi përbënte temën kryesore të diskutimit në mbledhjen e 21 tetorit të delegatëve nga organizatat e Lidhjes Socialiste të Serbisë, Vojvodinës dhe Kosovës, mbajtur në Gjilan të Kosovës. Gjithashtu, në mbledhjen e 20 tetorit të Kryesisë së Lidhjes së Komunistëve të Komitetit Krahinor të Kosovës u pranua se stabilizimi i situatës politike në Kosovë do të ishte çështje kryesore në zgjedhjet dhe aktivitetin tjetër organizativ që do të çonte në Konferencën e 13-të të LK të Kosovës më 2 prill.

5. Jugosllavia vazhdon të fajësojë Shqipërinë si nxitëse të trazirave në Kosovë ndërkohë që Tirana vazhdon të akuzojë Jugosllavinë për "martirizimin" e personave të dënuar dhe të mbështesë kërkesën për statusin e Republikës për Kosovën. Megjithatë, Jugosllavia e pranon se "armiku" ishte në gjendje të dëmtonte rëndë, duke luajtur me dobësitë e Jugosllavisë. Kështu, ka thirrje të



vazhdeshme nga autoritetet jugosllave për aksion më të drejtpërdrejtë politik në masat e gjera, për ndryshime në "të gjitha zonat e ekzistencës politiko-ekonomike", për zhvillimin e vetëmshimit, forcimin e vëllazërimit dhe bashkimit e popujve dhe kombësive, etj. Gjithsesi, ka pasur pak, nëse është bërë ndonjë, propozim konkret.

6. Jugosllavët refuzuan, dhe për arsye të fortë, që të trajtonin me vendosmëri çështjen e aspiratave të Kosovës për statusin e Republikës, megjithëse kjo ishte kërkesa kryesore e demonstruesve dhe është tema kryesore e leksioneve të Tiranës (shih komentet e Ministrisë të Mbrojtjes Lubiqiç për këtë çështje në telegramin tonë ZLGR4706 160CT). Jugosllavët vazhdojnë të pohojnë, së paku për konsumim publik, se qëllimi i atyre që organizuan demonstratat pranverën e kaluar, ishte shkëputja eventuale e Kosovës dhe bashkimi me Shqipërinë. Për Beogradin, shqyrtimi me seriozitet dhe, aq më pak, dhënia e statusit të Republikës do t'i shkëpuste në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhjet historike dhe kulturore të Serbisë me Kosovën. Për më tepër, ngritja e Kosovës në statusin e Republikës mund të nxiste në mënyrë të imagjinueshme Vojvodinën që të kërkonte një trajtim të tillë të ngjashëm. Shkurtimisht, është vlerësuar politikisht e pamundur që të adresohen kërkesat për statusin e Republikës sepse, po të bëhej një gjë e tillë, do të kërcënohej ekuilibri delikat ndërmjet elementëve të mëparshëm armiqësorë që formojnë Federatën aktuale.

7. Presioni ndaj qeverisë jugosllave për t'u marrë drejtpërdrejt me dilemën politike mund të lehtësohej nëse kjo qeveri do të merrte masa ekonomike për të rritur nivelin e punësimit si dhe standardin e jetesës në Kosovë, duke e ulur kështu nivelin e përgjithshëm të pakënaqësisë. Sidoqoftë, rrethanat aktuale ekonomike janë të tilla që është vështirë të gjenden fondet e kërkuara për investimet. Republikat e industrializuara të tilla si Kroacia dhe Sllovenia nuk pëlqejnë që të transferojnë të ardhurat e tyre për investime në Kosovë, dhe decentralizimi i jashtëzakonshëm aktual i

menaxhimit ekonomik bën që Beogradi të imponojë politika të tilla.

8. Zyrtarë të njohur të cilët pretendojnë se vështirësitë ekzistuese nuk mund kapërcehen para një a dy vjetësh mund të akuzohen gjithashtu për optimizëm të tepruar. Ka pak shanse për zgjidhje përfundimtare të problemit të Kosovës në të ardhmen e parashikueshme dhe megjithëse qeveria ndoshta do të jetë në gjendje të mbajë situatën nën kontroll, Kosova do të vazhdojë të ziejë.

CCC/088 231507Z ZLGR4732

-111-

Konfidenciale

HMA - O/R

DA - O/R

30 tetor 1981

Vizita në Kosovë (24-27 tetor)

1. Kalova fundjavën dhe të hënën në Kosovë, udhëtova me tren të shtunën dhe u ktheva me avion këtë mëngjes (27 tetor). Të dielën shkova në Pejë ku qëndrova një ditë dhe një natë, e që andej kalova në Prizren të hënën, e më pas vonë në mbrëmje u ktheva në Prishtinë. Të gjitha këto udhëtime të brendshme i kam bërë me autobus.

2. Situata e sigurisë. Nuk pashe ndodhi të pahijshme, megjithëse të tre qytetet ishin nën kontroll të fortë, si nga milicia dhe ushtria. Përqendrimi më i madh i pajisjeve dhe forcave të sigurisë ishte në Prishtinë, më i vogli në Prizren. Lokalizova vendin e fushimit të Ushtrisë Popullore Jugosllave (JNA), një fotografi e së cilës u botua në gazetën "Ilustrovana Politika" pak javë më parë, një pikë midis Mitrovicës dhe Vushtrisë (që dallohet qartë nga treni). Në Prishtinë, pashe disa automjete të blinduara milicësh, të cilat ngjanin me tipin "pigs" (të lyaerë ngjyrë blu) dhe ishin me timon në krahun e djathtë. Këto automjete ishin të parkuara të gjitha jashtë kazermave të milicisë në qendër të qytetit dhe ruheshin nga "forcat speciale" që mbanin bereta gjatë ditës, por helmata çeliku pasi errësohej. Pashë vetëm një autokolonë të automjeteve ushtarake në lëvizje, rreth 30 automjete jashtë Suharekës, por këto mund të ishin lëvizje normale të Ushtrisë Popullore Jugosllave.

3. Kontrollat. Nuk kishte asnjë të tillë në tren (përveç kontrolleve normale të biletave që bëheshin në dalje të Kosovës). Vetëm pasi isha regjistruar në hotel në Prishtinë, më kërkuan lejekalimin të lëshuar me Protokoll të FSFA. Pas kësaj, nuk më kërkuan më që ta nxirra megjithëse, e dorëzova vullnetarisht në hotelin në Pejë dhe përsëri kur u ktheva në hotel në Prishtinë. Asnjë nga autobusët në të cilët udhëtova, nuk u ndaluan nga policia, megjithëse një numër i madh makinash private u ndaluan. Të shtunën pasdite, policia po kontrollonte dokumentet e afërsisht një në dhjetë shoferë në rrugët kryesore të Prishtinës, e madje edhe ato që kishin makina me markën e regjistrimit të Prishtinës. Nuk pashe asnjë rast të tillë në Pejë apo Prizren.

4. Kisha parashikuar që do të kishte kontrole të dokumenteve në aeroportin e Prishtinës këtë mëngjes. Por as pasagjerët në fluturimet që vinin nga Beogradi dhe as ne që niseshim për Beograd, nuk ishim të detyruar që të identifikoheshim. Ishte pajisja e zakonshme me rreze X për kontrollin e bagazheve dhe trupit, por nuk kishte kontrole të tjera të trupit. Nuk pashe asnjë mjet ushtarak në fushën e aviacionit, e cila ishte tërësisht e veçuar nga avioni ynë dhe një biplan i hershëm.

5. Nuk vura re ndonjë gjë që dukej e pazakontë në fshat, përveç si më poshtë:

i) Shenja (në disa gjuhë, përfshirë në gjuhën angleze) në rrugët kryesore përmes të cilave të huajt paralajmëroheshin të mos ndalonin përveç se në "zona të banuara";
ii) Roje të armatosura në disa pemishte ndërmjet Gjakovës dhe Prizrenit, ku po viley prodhimi i mollëve;
iii) Patrulla jashtë shërbimit që dukeshin si trupa malore që kishin zbritur në Pejë;
iv) Në Lutjen e mbrëmjes së Manastirit të Graçanicës, kongregacioni përbëhej nga dy ushtarë dhe unë. Njëri ushtar ishte pothuajse i përgjumur, ndërsa tjetri po shikonte mbi supin e priftit, duke u përpjekur të ndiqte litaninë sllave. Nuk pashe asnjë rojë në Patrikanën e Pejës të dielën, ku riparimet e Konakut janë në përfundim të plotë (megjithëse, sipas priftit, jo aq

shpejt sa duhet; murgeshat janë kthyer përsëri, por ato ende nuk kanë ngrohje dhe ujë). Nuk kishte roje as në Deçan (Stacioni i zjarrfikësve në Pejë ka katër makina. Ky stacion nuk është më shumë se një kilometër nga Patrikana).

6. Manifestime nacionaliste. Disa shtëpi në vend, një pjesë e të cilave janë ende duke u ndërtuar, kishin flamuj të mëdhenj shqiptar të dalë prej tyre. Në Pejë, pashe një që ishte zgjatur nga qepenët e çatisë. Pashë disa parulla "Kosova - Republikë", të cilat kishin qenë gjysmë të mbuluara me bojë, por shumë prej tyre shënonin mbi to "Shoku Tito". Të dielën, pashe një duzinë a më shumë procesione martesash në Pejë, ku të gjitha kishin flamurin shqiptar të dalë nga makina e parë drejtuese, përveç një rasti që kishte një flamur Federal të bërë në shtëpi (flamuri tre-ngjyrësh ishte bërë lëmsh dhe ylli ishte i tëri i kuq, d.m.th. pa konturën e verdhë). Nuk pashe shumë veshje demonstrative të kostumeve dhe qelesheve kombëtare, përveç një të riu që mburrej me veshjen e tij si një bej shqiptar, dhe një zonje që nuk i dallohej moshën, e cila doli në mëngjes në Pejë e veshur me një kostum të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe makijazhin e viteve 1980.

7. Përshtypje të përgjithshme. Kjo ishte vizita ime e parë në Kosovë. Prapambetja e krahinave rurale dhe lagjet e varfra të Prizrenit më bënë përshtypje si jo më të këqija se ato në Mal të Zi. Nëse papunësia dhe varfëria janë të përhapura në Kosovë, së paku pjesërisht janë të kompensuara nga çmimet e ulëta. Biletat që merrja për autobus (për distanca rreth 80 km) kushtonin 50 dinarë. Një vakt me dy pjata, përfshirë edhe verë, në hotelin kryesor në Pejë, kushtonte 180 dinarë. Një kafe në Prizren kushtonte 13 dinarë. Të gjitha këto kushtonin dyfish në Beograd. Fola me disa studentë shqiptarë për trazirat. Ata u anuan për papunësi, por thanë se ky ishte një fenomen universal dhe vetë atyre u vinte turp për çfarë kishte ndodhur. Asnjë prej tyre nuk tregoi simpatinë më të vogël apo dëshirën për të vizituar Shqipërinë (vetëm njëri prej atyre me të cilët fola, kishte udhëtuar jashtë Jugosllavisë, në Zvicër, ku kishte të afërmit e tij).

8. Kujtime që zgjasin.

i) Një grua shqiptare, e cila dukej të paktën 55 vjeçe, e rrethuar nga tetë fëmijë në një stacion autobusi, dhe duke i dhënë gjë të nëntit.

ii) Një burrë duke u rruar në mes të një fushe, duke e vënë pasqyrën e tij mbi një kovë.

9. Të shtunën mbrëmja takova shkurtimisht në Prishtinë Z. Crawford. Nxora përfundimin që përshtypjet e tij mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga përshtypjet e mia, meqenëse ai po udhëtonte me makinë dhe merrte disa autostopistë, të cilët kishin gjëra më të rëndësishme për të thënë.

D. I. Miller

27 tetor 1981

Për dijeni: J C R Gray Esq, EESD, FCO



-112-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
2 nëntor 1981
FCO
I dashur Charles,

Kosova: Mbledhja e 22-të e Komitetit Qendror të LKJ-së Përmbledhje

1. KQ i LKJ diskutoi në mbledhjen e 22-të më 17 nëntor 'Programin e Veprimit Politik' për Kosovën. Kjo analizë e gjerë e trazirave të pranverës tregon një zhvillim të rëndësishëm të qëndrimeve zyrtare. Në veçanti, është bërë tashmë e ditur se politikat afatgjata të ndjekura në Kosovë ishin në thelb të gabuara dhe udhëheqja e Kosovës është dënuar haptazi se ka kërkuar nacionalizmin shqiptar. Megjithatë, diskutimet e gjalla të Komitetit Qendror të LKJ treguan se brenda Partisë kishte mosmarrëveshje mbi rekomandimet të caktuara. Gjatë debatit, situata e sigurisë në Kosovë u vlerësua si "e favorshme por ende jo e qëndrueshme"; Por, hidheshin mendime se mund të shqyrtoheshin në kohën e duhur disa nga dënimet e rënda të miratuara. Një delegat nga Vojvodina dënoi me ashpërsi nacionalizmin serb. Por, në përgjithësi, pak dolën informacione të reja.

Detaje

2. Siç u njoftua më parë (në letrën time dërguar për ju më 9 Nëntor), KQ i LKJ në mbledhjen e 22-të të tij u mor me çështjen e Kosovës. Diskutimi u vërtetë përrreth një dokumenti (mesa duket 50 faqe i gjatë) të titulluar "Platformë Politike për Veprim të LKJ në zhvillimin e vetë-menaxhimit socialist, vëllazërimit, unitetit dhe komunitetit në Kosovë", që ishte përgatitur nga një grup pune i ngritur pas Mbledhjes së 20-të të KQ të LKJ më 7 maj. Pas shqyrtimit përfundimtar, do të publikohet Platforma dhe teksti i diskutimeve të zhvilluara në Mbledhjen e 22-të, por shtypi ka botuar tashmë ekstrakte të gjera të vetë Programit dhe debatit të KQ. Të dhënat në vijim ndalen në dëshmitë e gazetës "Politika" dhe "NIN" dhe

janë përmbledhje e aspekteve të brendshme të Mbledhjes; Orientimi Jugosllavi-Shqiptar dhe një vlerësim më i përgjithshëm i kësaj mbledhjeje të rëndësishme po raportohen më vete.

Programi i Veprimit Politik

3. Ndërkohë që nuk mund të komentojmë përfundimisht mbi rekomandimet e Programit në lidhje me zhvillimin e ardhshëm ekonomik dhe politik të Kosovës deri kur të shikojmë tekstin e publikuar, konkluzionet në vijim japin shkaqet e trazirave nacionaliste në Kosovë tetë muaj më parë. Forcat nacionaliste dhe forcat e tjera reacionare këmbëngulin ende në Jugosllavi dhe përreth saj, thuhet në Platformë, por gabimi i madh i udhëheqjes së Kosovës u dha atyre hapësirë për të vepruar duke mos arritur që të bënin një dallim të qartë midis politikave të LKJ dhe qëllimeve nacionaliste. Me të vërtetë, elementë të caktuar brenda udhëheqjes dhe Universitetit kishin qenë vetë "të mahnitur nga nacionalizmi", ku si rezultat ishte lejuar të përhapej indoktrinimi nacionalist në radhët e studentëve dhe të rinjve. Fakti që Kosova ishte bërë në aspektin ekonomik dhe politik efektivisht e mbyllur, kishte krijuar tokë pjellore për kërkesën 'Kosova-Republikë', ndërkohë që vendimmarrja elitare, burokratike dhe jo-demokratike në radhët e udhëheqjes së LKJ ka penguar përpjekjet e aktivistëve të Partisë për të luftuar krijimin e ndjenjës nacionaliste. Kishte dështuar strategjia për zhvillimin intensiv të kapitalit për të parashikuar nevojat e Krahinës, veçanërisht kur bëhej fjalë për punësimin e të rinjve; në të vërtetë, udhëheqja kishte neglizhuar nevojën për të zgjeruar bashkëpunimin ekonomik me pjesët e tjera të Federatës dhe në vend të kësaj ishte përqendruar për t'i bërë gjithnjë e më jo-realiste kërkesat për ndihmë për zhvillim të plotë. Një dënim ky i mallkuar dhe gjithëpërfshirës.

4. Platforma shprehet se situata aktuale në krahinë është ende jo e qëndrueshme. Vazhdojnë të shfaqen parulla dhe letra anonime me qëllim përhapjen e mosbesimit ndër-komunal dhe demoralizimin e popullit. Si ndaj serbëve dhe malazezëve po

ushtrohet presion që të largohen nga Kosova dhe po kështu, edhe ndaj shqiptarëve që janë përfshirë aktivisht në demaskimin e nacionalistëve. Por armiku ka marrë një goditje të rëndë nga aktivitetet e gjera të LK të Kosovës dhe popullit punonjës të Krahinës (në debatin e KQ të LKJ u zbulua se deri më 6 nëntor 1,036 njerëz ose ishin përjashtuar nga LKK ose 'ishin nxjerrë nga lista' dhe 11 organizata bazë të LKK ishin shkrirë).

5. Përshkrimi i Platformës mbi shkaqet e vështirësive aktuale në Kosovë vazhdon më tej në mënyrë depërtuese. Por, sugjerimet e bëra në këtë Platformë në lidhje me veprimin në të ardhmen duket se janë më të turbullta. Në thelb, Platforma bën thirrje për një aksion mjaft më të madh dhe më intensiv nga Partia në Kosovë, me përpjekje të veçanta në shkolla dhe kolegje për të kundërshtuar vitet e indoktrinimit nacionalist të frymëzuar nga inercia, dhe për zhvillimin politik dhe ekonomik dhe që ky zhvillim politik dhe ekonomik i Kosovës të bashkërendohet më ngushtë me atë të Serbisë dhe pjesës tjetër të Jugosllavisë, duke e vënë theksin në investimet për krijimin e vendeve të punës. Sidoqoftë, megjithëse këto qëllime janë të përgjithshme, diskutimi në KQ tregoi se implikimet për t'i dhënë atyre përmbajtje nuk ishin të pakundërshtueshme.

Diskutimet në KQ-së të LKJ-së

6. Debatet për Platformën në radhët e KQ të LKJ zgjatën për dymbëdhjetë orë dhe në të morën pjesë 22 anëtarë të KQ.

Dobroslav Qullafiq, Sekretar i Kryesisë së LKJ, hapi debatin dhe diskutoi me radhë pikat e ndryshme të vëna në Platformë. Ai vuri në dukje disa shenja pozitive në Kosovë të tilla si faktin që 450,000 studentë dhe nxënës i ishin kthyer mësimi në mënyrë paqësore dhe faktin që prodhimi ekonomik po e merrte veten sërish; por 'armiku' ishte ende aktiv në shkrimin e parullave, dërgimin e letrave anonime dhe në forma të tjera të ndryshme ngacmimi. Kjo situatë po shkaktonte pasiguri, veçanërisht në mesin e serbëve dhe malazezëve. Duhej gjetur mënyra për të ndaluar shpërnguljen e tyre

- përndryshe armiku mund të krijonte një "Kosovë etnikisht të pastër". Qullafiq tha se për t'i dhënë të rinjve në Kosovë shanse më të mira ekonomike brenda Jugosllavisë, ata duhej të mësonin si gjuhën serbo-kroate, ashtu edhe shqipe. Lidhur me rolin e shtypit, ai tha se kishte pasur raste të raportimit apo sensacionalizmit të paekuilibruar, por sa më shumë që zyrtarët publikë ishin objektivë dhe kritikë për ngjarjet në Kosovë, aq më konstruktiv do të ishte roli i shtypit.

7. Sinan Hasani tha se përveç Kryesisë së LKJ, kishte pasur një grup njerëzish në Kosovë, të cilët në mënyrë vullnetare kishin pranuar përgjegjësinë për situatën aty, por LKK kishte ngritur tashmë një grup pune për ta çuar përpara këtë proces. Autoriteteve u mungonte ende një analizë e vërtetë e problemeve të shpërnguljes: "Ne duhet të distancojmë me vendosmëri veten nga numri jo i parëndësishëm i 'avokatëve' dhe 'oportunistëve' të cilët shpërnguljen e serbëve dhe malazezëve ia ngarkojnë ekskluzivisht vetëm arsyeve ekonomike". Nevojitej një veprim pa ekuivoke kundër të gjithë atyre që ushtrojnë presion të ashpër ose psikologjik për të rritur nivelin e shpërnguljes.

8. Gjeneral Bruno Buletqi tha se anëtarët e Partisë në radhët e JNA ishin të habitur për faktin se armiku nuk ishte identifikuar ende. "Disa mendojnë se armiku është gjithashtu i pranishëm në radhët tona". Anëtarët e JNA me detyrë në Kosovë prej disa muajsh kanë qenë subjekt i presioneve të ndryshme për t'i detyruar që të braktisin betejën. Gjithashtu, po përhapeshin gënjeshtër për lëndime të supozuara të shkaktuara me tanke ndaj fëmijëve; JNA ishte shpikur se ishte ushtri pushtimi. Por, ushtria ishte angazhuar në një shumëlojshmëri skemash të punëve publike dhe aktivitetesh komunitare me vlerë që arrijnë në disa dhjetëra milionë dinarë.

Dënimi i nacionalizmit serb

9. Dushan Popoviq, nga LK e Vojvodinës bëri fjalimin më të sinqertë. Ai tërhoqi vëmendjen në dy paragrafë të Platformës ku diskutohej pozita e Kosovës si krahinë autonome brenda Serbisë dhe, në veçanti, përmendeshin interpretimet e njëanshme të karakterit të federalizmit jugosllav. Njëri prej tyre kishte gjetur shprehje në neglizhimin e zhvillimit vetë-menaxhues dhe në identifikimin mekanik të pozitës së krahinave dhe republikave. Popoviq deklaroi se, në përgjithësi, pozita e krahinave nuk mund të interpretohej në mënyrë arbitrare dhe tha se fjalët e cituara ishin të paqarta dhe të panevojshme. Më pas, në mënyrë të dukshme, ai pretendoi se për 6 muaj disa seksione të caktuara të shtypit dhe "grupe pseudo-shkencore" kishin bërë fushatë denigruese kundër krahinave. Trazirat kombëtare në republikat e tjera nuk e kishin vënë asnjëherë në dyshim statusin e tyre si republika, tha ai. Nacionalizmi serb po e përdorte

parullën 'Kosova-Republikë' për të kërkuar likuidimin e dy krahinave autonome - kjo forcë nuk duhej nënvlerësuar. Njerëzit po mashtronin veten nëse mendonin se nacionalizmi i Serbisë së Madhe ishte mundur gjatë luftës çlirimtare apo në Plenumin e Brionëve. Platforma duhet të ndryshohet për ta bërë të qartë të gjithë këtë situatë.

10. Miloško Drulloviq tha se paragrafët që kundërshtonte Popoviq, bazoheshin në deklarata të mëparshme të bëra në Mbledhjen e 22-të të KQ të LKJ më 7 maj. Nuk do të ishte me vend që të zgjeroheshin temat e Platformës në mënyrë që kërkonte Popoviq. KQ i LK të Serbisë ishte forumi i duhur për të diskutuar këtë çështje.

Të burgosur politikë?

11. Vërejtjet e Dushan Popoviqit u drejtuan jo vetëm ndaj akuzave të nacionalizmit serb. Ai tha se shtypi botëror kishte ngritur çështjen e dënimeve politike në Kosovë, gjë që Platforma duhej ta trajtonte; po kështu, folës të tjerë tërhoqën vëmendjen në politikën për dënimet në Kosovë. Në përmbledhjen e tij, Dushan Dragosavac, kryetar i kryesisë së KQ të LKJ, vuri në dukje se ishin shprehur shqetësime, por tha se besonte që procedurat normale të Gjykatës së Apelit do të korrigjonin të gjitha gabimet e bëra. Por, padyshim, nuk mund të kishte ndërhyrje në pavarësinë e gjykatave!

Përçindja e lindjeve në Kosovë

12. Dragutin Kosovac tha se LKJ besonte që përçindja e lartë e lindjeve ishte pasojë dhe jo shkak i prapambetjes, por Zvone Dragan dëshironte që Platforma të shpjegonte nevojën për një politikë afatgjatë të popullsisë që synonte reduktimin në mënyrë graduale të përçindjes së lindjeve. Megjithatë, Peko Dapçeviq dëshironte që një ide e tillë të hidhej poshtë. Ai tha se diskutimi mbi numrat e ndryshëm të serbëve apo kroatëve apo shqiptarëve në Jugosllavi ishte mjaft i turpshëm. Sidoqoftë, Dr. KoçaJonçiq tha se inkurajimi i "rritjes së ekzagjeruar" të popullsisë shqiptare nga elementët nacionalistë i shoqëruar me shpërnguljen e detyruar të serbëve dhe malazezëve çonte në një përfundim: "Një Kosovë etnikisht të pastër". Përfundimisht, u ra dakord për një tekst, i cili fliste për "të drejtën dhe nevojën e popullit të Kosovës për të shënuar pasojat e rritjes së popullsisë në planin shoqëror dhe për rrjedhojë për të marrë masat përkatëse..." (KOMENT: Fakti që kjo temë po transmetohet në këtë mënyrë është tejet i rëndësishëm, por progresi për këtë do të kërkojë trajtimin me delikatesën më të madhe nëse nuk do të fillojnë të përhapen akuzat e dëmshme të formave më të ashpra të racizmit). Përmbledhje

13. Në një përmbledhje të kufizuar dhe pothuajse madhështore, Dushan Dragosavac tha se tabloja e përgjithshme ishte pozitive. Megjithatë, kishte ende shumë për të bërë, por gjatë viteve, Kosova

kishte bërë shumë progres. Shtypi duhej inkurajuar që të shikonte anën pozitive, se mos miqtë e Jugosllavisë jashtë vendit arrinin në konkluzionin që autoritetet nuk kishin një politikë efektive (!). Kërkohej një nivel më i lartë dhe më i mprehtë i punës politike. Platforma do të ndihmonte që LKJ t'ia dilte mbanë në këtë drejtim.

I Juaji
Charles Crawford
Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit,
P Rosling Esq
Konsulli Përgjithshëm i Madhërisë
së Saj
Zagreb

-113-

Informacion mbi udhëtimin e zyrtarëve në Kosovë dhe Maqedoni, 23-24 tetor 1981
Kosova: përshlyetje dhe diskutime të përgjithshme me autostopistët

1. Eca me makinë nga Rashka në Serbinë Jugore më 24 Tetor për në Mitrovicë e më pas në Pejë, Prizren dhe Prishtinë ku kalova natën. Të nesërmen, eca me makinë nga Kosova përmes Ferizaj për në Tetovë, ku më pas vazhdova për në Ohër dhe u ktheva sërish përmes Dibrës për në Shkup. Këtu bëra disa vëzhgime të përgjithshme.

Rrugët
2. Kam udhëtuar nga Beogradi për në Rashkë në një stuhë të furishme. Megjithatë rrugët ishin mjaft të mira, shiu kishte sjellë poshtë kodrave shkëmbinjtë dhe gurë, disa prej të cilëve me masën e një valixheje të cilët ishin ende aty të nesërmen. Hyrjet dhe daljet për në tunele ishin veçanërisht të rrezikshme në këtë drejtim. Rrugat nga Novi Pazar për në Mitrovicë ndjek lumin Ibër dhe disa nga urat mbi degë ishin në gjendje të vështirë riparimi, por ndryshe rrugët në Kosovë ishin të asfaltuara mirë dhe përreth kishte pak trafik. Situata e sigurisë

3. Policia nuk më ndaloi deri kur arrita 20 kilometër në brendësi të Kosovës, por ata ishin të sjellshëm e të përzemërt dhe, pasi kontrolluan lejen time dhe më ofruan një cigare, më lejuan të largohesha. Dukej se në Mitrovicë, Pejë dhe Prizren kishte shumë policë, por ata ishin të qetë dhe duke biseduar lirshëm me publikun; Disa prej tyre në Pejë kishin revolverë. Në Ferizaj unë pashë vetëm tre ushtarë me automatikë jashtë burgut të qytetit. Një makinë policie më ndoqi duke rënë në sy në Gjakovë deri kur arrita kufijtë e qytetit ndoshta për shkak se kishin vënë re se kisha një familje shqiptare në makinë. Megjithatë, në Prishtinë kishte shumë ushtarë të armatosur me automatikë, të cilët qëndronin në qoshe të rrugëve afër zyrave të forcave të sigurisë dhe gjetkë në pjesën kryesore të qytetit pranë Grand Hotel. Natyrisht, ata ishin në detyrë dhe nuk kishin të bënin me popullsinë lokale. Vura re se disa prej tyre kishin helmata me ngjyrë blu prej çeliku me yll të kuq në pjesën e përparme (gjatë natës). Të nesërmen në mëngjes, kishte shumë më pak prej tyre.

4. Gjatë udhëtimit mora disa autostopistë. Ata, ose nuk kishin makina ose nuk e përballonin që t'i mbanin ato dhe shërbimet e autobusëve lokalë ishin të mbushur dhe të parregullt. Biseda ime më interesante ishte me një shqiptar tipik me kapele të bardhë të cilin e mora nga Mitrovica për në Pejë. Pa ndonjë nxitje të veçantë nga ana ime (në të gjitha rastet më parë unë e kisha paraqitur veten si anëtar i Ambasadës në rast se ata nuk dëshironin që të përziheshin me mua) ai foli lirshëm. Ai tha se aktualisht punonte si shofer në Zvicër dhe se kishte punë të tjera në Evropë dhe se po kthehej në shtëpi për të bërë disa ndërtime aty. Ai kishte gjashtë (?) fëmijë dhe banonte në një shtëpi komunale me 40 veta me vëllëzërit dhe motrat e tij si dhe fëmijët e tyre. Ata ia jepnin paratë e tyre kryetarit të familjes, i cili e drejtonte vendin si një biznes! Unë e pyeta se pse kosovarët kishin kaq shumë fëmijë. Ai qeshi dhe tha se djemtë dhe vajzat shpesh martoheshin në moshën 15-vjeçare. Ai tha se studentët nuk kishin kërkuar Republikë në demonstratat e tyre, por thjesht kishin kërkuar bursa më të mira – bursat e tyre aktuale ishin një e treta e bursave që merrnin studentët në Slloveni. Jugosllavia nuk kishte një sistem të vërtetë "socialist" siç sundonte në Shqipëri, ku njerëzit punonin shumë dhe çdo gjë shpërndahej në mënyrë të barabartë. Unë thashë se jugosllavët gëzonin shumë më shumë liri. Ai ra dakord se liria ishte në fund të fundit gjëja më e rëndësishme. E pyeta pse serbët dhe malazezët largoheshin nga Kosova. Ai tha se nuk kishte pasur raste presioni. Ata kishin ardhur aty dhe kishin blerë tokën "tonë" para Luftës së Dytë Botërore dhe tani që çmimet e tokave ishin rritur shumë shpejt për shkak të presionit të popullsisë, ato po nxirrin para përmes shitjes së tyre dhe po largoheshin. E pyeta përse ata do të shqetësoheshin të bënin supozime për presion nëse në të vërtetë nuk kishin ndodhur. "Ata të gjithë po na godasin ne" tha ai. Kosova ishte pjesa më e pasur e vendit në burimet e saj natyrore, por ato të gjitha po gërmoheshin dhe po kalonin në pjesë të tjera të Federatës. Kosova po shfrytëzohej ekonomikisht dhe ajo që kërkonte, ishin vetëm të drejtat e saj kushtetuese. E lashë atë në periferi të Pejës meqenëse nuk dëshironte që të hynte me makinë në qytet nga frika se mos policia e shihte dhe e arrestonte për bashkëpunim me të huajt (Koment: Ky person e fliste shkëlqyeshëm serbishten që nuk ishte e lidhur gjerësisht me betimet. Ai dukej mjaft inteligjent dhe kishte pikëpamjet e veta të cilat mund t'i mbronin me forcë. Megjithatë kishte ide të turbullta se si ishte Shqipëria në të vërtetë, mendova se ai kishte gjetur idenë e disiplinës, punës së shumtë dhe shpërndarjes së drejtë të pasurisë së shoqërisë në kundërshtim me atë që ai shihte si qëndrimin e dobët të Jugosllavisë për këto gjëra).

5. Në Pejë bëra një udhëtim prej dy orësh duke kaluar përmes rrugës

malore të ashpër por spektakolare drejt Titogradit dhe u ktheva për të përcjellë tre djem të moshës 13-vjeçare. Ata ishin shqiptarë dhe nuk flisnin asnjë fjalë serbisht. Midis Pejës dhe Gjakovës përcolla një të ri shqiptar së bashku me gruan dhe fëmijën e tij. Edhe ai kishte punuar jashtë vendit. Ai u ankua për praninë e policisë në Pejë dhe tha se të rinjtë aktualisht po detyroheshin të hynin në shërbimin ushtarak para kohe, gjë që nuk kishte ndodhur para demonstratave. E pyeta për familjen e tij. Ai kishte vetëm dy fëmijë deri tani, por qeshi me kontradiktën (siç e quajti ai) ndërmjet faktit që Mali i Zi kishte një popullsi shumë më të vogël se Kosova, por ishte Republikë, ndërkohë që Kosova nuk ishte. E ndjeva se ai, dhe padyshim miqtë e tij, kishin idenë që të ecnin në rrugën e tyre përmes forcës së thjeshtë të numrave në aspektin afatgjatë.

Qytetet
6. Megjithatë nga pikëpamja e sigurisë, të gjitha qytetet që unë pashë, dukeshin të qeta (nuk pashë ndonjë parullë apo pamflet), duhet të them se isha jashtëzakonisht i habitur nga prapambetja e dukshme. Kështu, në Mitrovicë e Madhe dhe në Prishtinë, cilido mund të ecte nga rrugët kryesore të asfaltuara në qendër të qytetit drejt e në rrugët të cilat në fakt ishin të pakalueshme, me gjurmë balte dhe pa trotuare. Ferizaj ishte veçanërisht një vend i zymtë dhe i lodhur. Nuk pata mundësinë të udhëtoja në ndonjë nga fshatrat që ishin larg rrugës kryesore, por padyshim situata atje është edhe më e rëndë. Sidoqoftë, isha mjaft i befusuar nga prosperiteti në Pejë. Dyqanet aty dukeshin më të gjalla dhe megjithatë me një shikim të përciptë, qyteti dukej se kishte një atmosferë mjaft ambicioze.

Charles Crawford
2 nëntor 1981

-114-

Të dhëna mbi udhëtimin e zyrtarëve në Kosovë dhe Maqedoni, 23-28 tetor 1981
Maqedoni: përshlyetje të përgjithshme 2 nëntor 1981
Të përgjithshme politike

1. Të gjitha takimet dhe bisedat në Maqedoni mëçuan në konkluzionin se popullsia aty nuk kishte aspak simpati për kërkesat 'Kosova-Republikë'. Ekziston një shqetësim i natyreshëm se Maqedonia thjesht mund të zhduket nëse do të formohej Bullgaria e Madhe ose Shqipëria e Madhe. Maqedonasit po bëjnë përpjekje të fuqishme për të krijuar kulturën dhe identitetin e tyre etnik. Ata janë të përgatitur për të shpenzuar para që të krijojnë të gjitha mënyrat e letërsisë kulturore të shkëlqyer në një shumëllojshmëri gjuhësh të huaja. Ata duken krenarë për atë që kanë arritur që nga lufta dhe që prej tërmetit. Ata e shohin veten e tyre se u vete mbarë përmes Jugosllavisë.

Ndërtime të reja
2. Sidoqoftë, kam dëgjuar ankime

të shpeshta rreth papunësisë dhe paaftësisë së punonjësve malazezë dhe, megjithatë në shikim të parë vetë Shkupi duket realisht një qytet mjaft tërheqës, një shikim nga afër zbulon se shumë nga ndërtesat e reja nuk janë ndërtuar mirë. Ndërtesa e re e Universitetit që ka Fakultetet e Filozofisë dhe Gazetarisë, ishte një shembull i mirë në këtë drejtim. Ajo ka arkitekturë të ngurtë moderne (nëse pëlqeni këtë lloj), por si ndërtesë nuk ishte në funksion. Dyshemetë prej mermeri ishin thyer, çezmat nuk punonin, orët po ashtu, çatia pikonte dhe ishte vështirë që të ngroheshin aty brenda. Historia e zakonshme – ndërtesa, mesa duket, ishte krijuar në mënyrë të tillë që kërkonte shuma të mëdha "amerikane" për ta mbajtur atë siç duhet; Këto shuma nuk ishin mundësuar dhe kështu kjo ndërtesë nuk i përgjigjej kërkesave të popullsisë së shumtë studentore aty. Prapa "Grand Hotel" ka një hapësirë shumë moderne dhe të përshtatshme për blerje në disa kate. Dyqanet duket se ishin pajisur mjaft mirë, por për shembull në të njëjtin kompleks kishte disa videoteka që ofronin të njëjtat materiale me të njëjtin çmim. Pa pasur së paku njëfarë konkurrence energjike nëçmime, një treg i tillë është i destinuar të jetë i pamjaftueshëm.

Charles Crawford

-115-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Beograd
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit 6 nëntor 1981
Inderuar Charles,
Kosova

1. Një miku im avokat më tha ditën tjetër se rreth tre javë më parë studentët e Universiteteve të Beogradit, Zagrebit dhe Lubjanës organizuan një peticion në Kosovë.

2. Peticioni i është dërguar Kryesisë Federative dhe vë në diskutim gjatësinë e tepruar të dënimeve të dhëna për nacionalistët në Kosovë. Peticioni është nënshkruar prej rreth 230 studentëve.

3. Peticioni është pa dyshim interesant në vetvete si një shprehje e mëtejshme publike e kritikës. Sidoqoftë, po aq interesante është drita që hedh ky peticion në qëndrimin e mbajtur ndaj Kosovës nga Serbia, nga njëra anë, dhe Sllovenia dhe Kroacia, nga ana tjetër. Vetëm 30 studentë e nënshkruan peticionin në Beograd; ndërsa rreth 100 studentë e nënshkruan peticionin në Universitetet më të vogla në Lubjanë dhe Zagreb. Kjo pasqyron opinionin e shprehur para Ambasadorit në udhëtimin e tij të fundit në veri, d.m.th., që dënimit ishin shumë të rënda, si dhe pikëpamjen serbe se nacionalistët shqiptarë e merituan atë që morën.

4. Duket se nuk ka të ngjarë që ky peticion do të ketë ndonjë më shumë efekt tek autoritetet sesa peticionet e mëparshme.

I Juaji
T. J. Crank
Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit
FCO
P E Rosling Esq MVC, Zagreb

-116-

J C R Gray Esq

Ambasada britanike
Beograd
9 nëntor 1981
EESD
FCO
Inderuar Charles,

Kosova: situata politike

1. Komiteti Qendror i LKJ do të zhvillojë një mbledhje më 17 nëntor në të cilën do të shqyrtohet 'programi i veprimi' të Partisë për Kosovën. Ndërkohë, vlen të përmenden tri pika.

Situata e sigurisë në Universitetin e Prishtinës

2. Më 4 nëntor u raportuan disa trazira në Qendrën Studentore në Prishtinë kur një grup studentësh filluan të bërtasin dhe të fishkëllojnë në orën 10.30 të natës. Zhurma vazhdoi për pesë deri në shtatë minuta. Gazeta Politika raportoi më 7 nëntor se përgjegjësit e këtyre ngjarjeve ishin identifikuar dhe se ndaj tyre do të merreshin 'masa' (Koment: Kjo është e vetmja shenjë e trazirave në Universitet.

3. Universiteti që kemi parë që kur mësimi rifilloi në tetor dhe duket se ka qenë një incident i vogël, megjithatë duke pasur parasysh masat paraprake të rënda të sigurisë ende të dukshme në Universitet dhe dënimet e dhëna gjatë verës, mund të thuhet se është e çuditshme që ky incident ndodhi).

Shpërngulja e serbëve dhe malazezëve

4 Ka pasur shumë të dhëna (shih letrën time dërguar për ju më 30 shtator, paragrafi 6) në 'shtypin e Beogradit' gjatë javëve të fundit për problemin e rëndësishëm të shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve nga Kosova, por do të presim një vlerësim zyrtar të tabllës së përgjithshme për Krahinën. Megjithatë, raportet e shumta të shtypit sugjerojnë se procesi po vazhdon; gazeta "Politika" e 8 nëntorit raportoi ekzistencën e mentalitetit "ikni sa keni mundësi", i nxitur nga zërat armiqësore se shpërngulja nga Kosova do të ndalohej së shpejti.

Vahide Dushku

5. Letra ime përmendte gjithashtu (paragrafi 4) delegatën femër, Vahide Dushku, e cila foli kundër dënimeve të rënda në Kosovë në Mbledhjen e Kuvendit të Kosovës më 25 shtator. Gazeta "Borba" raportoi më 1 nëntor se ajo ishte dëbuar nga Partia se kishte shprehur solidaritet me nacionalizmin dhe irredentizmin. Gjithashtu thuhej se kishte filluar procesi për rikthimin e saj si delegate.

I Juaji
Charles Crawford
Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Leverkuseni fiton titullin e parë në histori pas 120 vitesh, Xhaka e feston me një ‘perlë’

LEVERKUSEN, 14 PRILL - Merr fund pritja 120 vjeçare. Bayer Leverkusen ka fituar titullin e parë në historinë e klubit, në Bundesligë. Ekipi i drejtuar nga Xabi Alonso “kurorëzon” në mënyrë më të mirë të mundshme sezonin futbollistik, duke thyer kështu

hegemoninë e Bayern. Të bindur se sot do ishte dita e festës, tifozët kishin mbushur rrugët, duke krijuar kështu një atmosferë të zjarrtë. “Aspirinat” triumfuan 5-0 ndaj Werder Bremen në BayArena, nën prezencën e mbi 30 mijë mbështetësve. Boniface

vendosi pjesën e parë, me një gol nga pika e bardhë e penaltisë. Në fillimin e pjesës së dytë, nuk mund të mungonte Granit Xhaka, një “perlë” e mesfushorit me origjinë shqiptare. Më pas, Wirtz thelloi shifrat (Tripletë). Kështu, Leverkusen, siguron

titullin disa javë përpara fundit të kampionatit, duke bërë që ndeshjet e radhës t’i luajë vetëm për formalitet. Në 29 takime, Xhaka me shokë nuk kanë provuar asnjëherë shijen e humbjes, ndërsa numëron 25 fitore dhe katërt barazime.



Llapi gabon sërish, fitojnë Ballkani dhe Drita

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 PRILL - Skuadra e Llapit ka bërë një tjetër hap “fals” në garën për titull të kampiones në Superligën e Kosovës në futboll, pasi të dielën ka barazuar me Dukagjinin e Klinës (1-1), në kuadër të javës së 29-të në Albi Mall Superligë. Në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “18 Qershori” në Klinë, Llapi kaloi në epërsi me golin e mbrojtësit Leotrim Bekteshi, me gjuajtje me kokë, në minutën e tretë shtesë në pjesën e parë. Shifrat i barazoi mbrojtësi i Dukagjinit, Ardin Dallku, po ashtu me gjuajtje me kokë, në minutën e 66-të. Në minutat shtesë të ndeshjes Llapi pati rast të pastër për gol, por Trimror Selimi nuk shënoi nga afërsia pas asistimit të

shkëlqyeshëm të Ahmed Januzit. Pas kësaj jave, Llapi është në kuotën e 55 pikëve në pozitën e tretë, derisa Drita është e dyta me 57 pikë dhe Ballkani kryeson renditjen me 59 pikë. Të dielën fitores i është gëzuar skuadra e Malishevës e cila e mposhti Fushë Kosovën me rezultat 3-1. Të parët në epërsi kaluan “Pampurat” me golin e Rilind Hazirajt, në minutën e 12-të. Malisheva në pjesën e dytë ishte më e mirë dhe e përmbysi rezultatin me dy golat e Damir Kojasheviqit (49’-pen.), Drilon Hazrollajt (54’) dhe Ilir Mustafës (66’). Pas kësaj fitore, Malisheva ka 52 pikë në vendin e katër, derisa Fushë Kosova mbetet në pozitën e parafundit me gjithnjë e më pak shpresa për mbijetesë. Të shtunë fitoreve i janë gëzuar Ballkani dhe Drita në përballje me Feronikelin 74, përkatësisht

Lirisë. Kryesuesit dhe kampionët në fuqi, Ballkani e mposhten “Niklin” në stadiumin “Rexhep Rexhepi” në Drenas me rezultat 0-2. Golat i shënuan Nazmi Gripshi dhe Danfa. Klubi

SUPERLIGA		
Dukagjini - Llapi		1-1
Fushë Kosova - Malisheva		1-3
Drita - Liria		4-2
Feronikeli 74 - Ballkani		0-2
Prishtina - Gjilani		1-3
Tabela		
		Pikë
1. Ballkani	29	59
2. Drita	29	57
3. Llapi	29	55
4. Malisheva	29	52
5. Prishtina	29	40
6. Dukagjini	29	37
7. Gjilani	29	33
8. Feronikeli 74	29	30
9. Fushë Kosova	29	20
10. Liria	29	10



i Ilir Dajës është në vendin e parë me 59 pikë, kurse Feronikeli në vendin e tetë me 30 pikë. Drita e mposhti Lirin me rezultat 4-2, golat për gjilanasit i shënuan Meris Maliqi, Blerim Krasniqi, Albert Dabiqaj dhe Fluturim

Domit (autogol). Tri pikë shumë të rëndësishme i arkëtoi edhe Gjilani në garë për t’iu shmangur barazhit kundër Prishtinës (3-1). Gjilani është në pozitën e shtatë me 33 pikë, kurse Prishtina në vendin e pestë me 40 pikë.

Prishtina triumfon në Ligën Ballkanike, Peja renditet e treta



PRISHTINË, 14 PRILL - KB Sigal Prishtina Mercure është shpallur për herë të tretë kampionë në Ligën Ballkanike. Në finalen e këtij viti, skuadra e drejtuar nga Albert Sylejmani mposhti AEL-in nga Limassoli, nikoqirët e “Final 4”. Ndeshja e zhvilluar në “Nicos Solomonides Arena” përfundoi me shifrat 72:67. Shaheed Davis me 16 pikë dhe Donte Clark me 15 sosh ishin basketbollistët më meritore në triumfin e prishtinasve. Te qipriotët u dalluan Jerai Grant dhe Jordan Shepherd me nga 17 pikë secili. Për Prishtinën është

hera e tretë në histori të klubit që fiton titullin e më të mirës në këtë garë, në finalen e tretë. Peja është renditur në vendin e tretë në Ligën Ballkanike. Kampionët e Kosovës për vendin e tretë kanë mundur Lovcen nga Mali i Zi me rezultat 93:82 (31:21, 19:19, 23:21, 20:21). Verdhezinjtë e nisën ndeshjen më mirë, duke fituar çerekun e parë 31:21, derisa më pas është zhvilluar lojë kryesisht e barabartë, por e mjaftueshme për Pejen që fitoi në fund me 11 pikë dallim, 93:82. Më i miri te Peja ishte Justin Davis me 34 pikë e dhjetë kërcime.

Besa Famgas mposhti Trepçën në ‘Minatori’

Mitrovicë, 14 prill - Besa Famgas e ka fituar derbin e xhiros së 26-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Të shtunën mbrëma në palestrën “Minatori” në Mitrovicë, Besa e mposhti Trepçën me rezultat 34:30. Ndeshja ishte e fortë. Vendasit startuan fuqishëm dhe

në pjesën e parë ishin vazhdimisht në epërsi. Por në pjesën e dytë pejanët shfaqën më shumë. Për herë të parë kaluan në epërsi në minutën e 44-t dhe më pas mbajtën epërsinë deri në fund. Por ndeshja nuk kishte fund normal. Me të përfunduar takimi, në

fushën e lojës kanë hyrë persona të paautorizuar. Dy prej tyre kanë realizuar sulm fizik ndaj arbitrave të lojës. Dyshohet që bëhet fjalë për ish-hendbollistë dhe kjo e bënë më të papranueshme ngjarjen. Federata e Hendbollit e Kosovës e dënua fuqishëm dhunën e

shfaqur, ndërsa organet e Federatës gjatë javës së ardhshme do të marrin vendimet meritorë lidhur me atë që ndodhi. Të shtunën u luajtën edhe dy ndeshjet tjera të xhiros së 26-të. Rahoveci fitoi 35:25 ndaj Vushtrrisë, ndërsa Prishtina e mposhti Vëllaznimit (61:38).





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zhvillues/e i/e Softuerit (Zyrtar/e i/e Ri/e) – 2 pozita
Grada e pozitës:	shtatë (7)
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	i Teknologjisë Informative dhe Sigurisë
Divizioni:	i Zhvillimit
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit të Zhvillimit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Zhvilluesi i softuerit merret me të gjitha fazat e zhvillimit të softuerit, duke filluar nga analiza e kërkesave, dizajnimi i softuerit, implementimi, dokumentimi e deri te testimi i softuerit. Gjithashtu, kontribuon në përmirësimin e softuerëve ekzistues, gjetjen e gabimeve dhe korrigjimin e tyre.

Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Merret me zhvillimin aplikacioneve softuerike;
- Dizajnon dhe krijon bazat e të dhënave për aplikacionet që zhvillohen;
- Dizajnon raporte sipas kërkesave;
- Bën automatizimin e testimit të aplikacioneve;
- Bën analizë të kodit (ang. Code review) të shkruar nga anëtarët e tjerë të ekipit;
- Identifikon gabimet në softuer dhe bën korrigjimin e tyre;
- Merr pjesë aktive në pranimin, analizimin dhe vlerësimin e kërkesave (ang. requirements) për zhvillimin e aplikacioneve të reja apo shtimin e funksionaliteteve në ato ekzistuese, si dhe bën korrigjimin e gabimeve (të identifikuar nga shfrytëzuesit);
- Mirëmban aplikacionet që zhvillohen dhe ato ekzistuese;
- Shkruan dokumentacion teknik të softuerit;
- Shkruan dokumentin udhëzues për përdorim të softuerit;
- Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga udhëheqësi.

Kualifikimet dhe përvoja:

- Shkallë universitare (baçelor) në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo të matematikës ose certifikime në fushën përkatëse;
- Preferohet të paktën 1 vit përvojë në zhvillim të softuerit;
- Preferohet përvojë në Angular dhe .NET;
- Gjuha angleze, e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **29 prill 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta:	Softver developer (mladi službenik) – 2 pozicije
Stepen pozicije:	sedam (7)
Trajanje zapošljavanja:	na neodređeno vreme
Odeljenje:	za informacionu tehnologiju i bezbednost
Odsek:	za razvoj
Izveštava:	rukovodiocu Odseka za razvoj

Dužnosti i odgovornosti:

Softver developer se bavi svim fazama razvoja softvera, počevši od analize zahteva, dizajna softvera, implementacije, dokumentovanja do testiranja softvera. Takođe, doprinosi unapređenju postojećih softvera, pronalaženju i ispravljanju grešaka.

Radne dužnosti i odgovornosti:

- Bavi se razvojem softverskih aplikacija;
- Dizajnira i kreira baze podataka za aplikacije koje se razvijaju;
- Dizajnira izveštaje prema zahtevima;
- Automatizirati testiranje aplikacija;
- Vrši analizu koda (eng. Code review) kojeg su napisali ostali članovi tima;
- Identifikuje softverske greške i ispravlja ih;
- Aktivno učestvuje u prihvatanju, analizi i proceni zahteva (eng. requirements) za razvoj novih aplikacija ili dodavanje funkcionalnosti postojećim, kao i radi ispravljanje grešaka (koje su identifikovali korisnici);
- Održava aplikacije koje se razvijaju i one postojeće;
- Piše tehničku dokumentaciju softvera;
- Piše dokument sa uputstvima za korišćenje softvera;
- Obavlja i druge zadatke koje odredi rukovodilac.

Kvalifikacije i iskustvo:

- Univerzitetska diploma (bačelor) iz oblasti računarstva, elektrotehnike ili matematike ili sertifikati iz odgovarajuće oblasti;
- Poželjno najmanje 1 godina iskustva u razvoju softvera;
- Poželjno je iskustvo u Angular i .NET;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Procedura prijave:

- Zadnji rok za prijavu je **29 april 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik podnošenja prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: www.bqk-kos.org



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar/e Mbështetës/e i/e Teknologjisë Informative
Grada e pozitës:	gjashtë (6)
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	i Teknologjisë Informative dhe Sigurisë
Divizioni:	i Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve

Zyrtari për Helpdesk do të mirëmbajë pajisjet kompjuterike duke analizuar kërkesat e shfrytëzuesve, zgjidh problemet që kanë me shfrytëzimin e pajisjeve që janë në domenin e teknologjisë informative, instalon harduerin, ofron zgjidhje të ndryshme softuerike dhe mirëmban sistemin për gjenerimin e kërkesave të Helpdesk-ut.

Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Ofron përkrahje, trajton dhe zgjidh problemet e natyrës së teknologjisë informative.
- Shërben si nivel i parë i komunikimit dhe trajtimit të incidenteve dhe problemeve tek të gjithë shfrytëzuesit e teknologjisë informative.
- Monitoron dhe përgjigjet në tiketat e raportuara në Departamentin e TI.
- Raporton çështje tjera dhe sipas rastit i ngritë ato në nivel të administratorëve.
- Ofron përkrahje për ndërlidhjet me institucionet shtetërore dhe institucioneve financiare.
- Menaxhon pajisjet e shfrytëzuesve, duke përfshirë instalimet dhe shpërndarjen e azhurnimeve dhe ndryshimeve përmes Microsoft Endpoint Manager (ish System Center Configuration Manager)
- Përditëson dokumentimin e zgjidhjeve të aplikuara.
- Monitoron dhe mirëmban sistemin e printimit.
- Instalon dhe kryen përditësimet e nevojshme për aplikacione te caktuara.
- Mirëmban sistemin e inventarizimit për të gjitha pajisjet e teknologjisë informative, softuerëve dhe licencave që përdoren në BQK.
- Merr pjesë aktive në përgatitjet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata të TI.
- Detyra tjera që i caktohen nga përgjegjësit në hierarkinë e Departamentit të Teknologjisë Informative

Kualifikimet dhe përvoja:

- Shkallë bachelor në shkenca kompjuterike ose certifikime përkatëse që lidhen me rolin e Helpdesk-ut, CompTIA+, MCSA Windows 10 ose MDAA.
- Përvojë prej së paku 2 viteve në Helpdesk.
- Përvoja në ambiente komplekse të infrastrukturës së TI e preferuar.
- Përvoja ose certifikim në ITIL i preferuar.
- Të kënë përvojë në instalimin e përditësimeve të
- Aftësi të mira komunikuese dhe shkathësi për të zgjidhur problemet në mënyrë të pavarur.
- Gjuha angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raportin nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **29 prill 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta:	Službenik podrške za informacionu tehnologiju
Stepen pozicije:	šest (6)
Trajanje zapošljavanja:	na neodređeno vreme
Odeljenje:	za informacionu tehnologiju i bezbednost
Odsek:	za informacionu tehnologiju i sisteme
Izveštava:	rukovodiocu Odseka za informacionu tehnologiju i sisteme

Službenik šaltera za informacije će održavati računarsku opremu analizirajući zahteve korisnika, rešavati probleme koje imaju u korišćenju uređaja iz domena informacionih tehnologija, instalirati hardver, obezbeđivati različita softverska rešenja i održavati sistem za generisanje zahteva šaltera za informacije.

Radne dužnosti i odgovornosti:

- Pruža podršku, obrađuje i rešava probleme prirode informacione tehnologije.
- Služi kao prvi nivo komunikacije i rešavanja incidenta i problema za sve korisnike informacionih tehnologija.
- Prati i odgovara na prijave prijavljene Odeljenju za IT.
- Izveštava o drugim pitanjima i po potrebi ih podiže na nivo administratora.
- Pruža podršku za odnose sa državnim institucijama i finansijskim institucijama.
- Upravlja uređajima korisnika, uključujući instaliranje i distribuciju ažuriranja i promena putem Microsoft Endpoint Manager (ranije System Center Configuration Manager)
- Ažurira dokumentaciju primenjenih rešenja.
- Nadgleda i održava sistem štampanja.
- Instalira i izvodi neophodna ažuriranja za određene aplikacije.
- Održava sistem inventara za svu opremu informacione tehnologije, softvera i licenci koje se koriste u CBK-u.
- Aktivno učestvuje u kratkoročnim i dugoročnim pripremama i planiranju za IT.
- Ostale dužnosti koje određuju odgovorni po hijerarhiji Odseka za informacione tehnologije.

Kvalifikacije i iskustvo:

- Bačelor diploma iz računarskih nauka ili relevantni sertifikat koji se odnose na ulogu šaltera za informacije, CompTIA+, MCSA Windows 10 ili MDAA.
- Iskustvo od najmanje 2 godine na šalteru za informacije.
- Poželjno iskustvo u složenim okruženjima IT infrastrukture.
- Poželjno iskustvo ili certifikacija u ITIL-u.
- Imati iskustva u instaliranju ažuriranja za
- Dobre komunikacijske veštine i sposobnost samostalnog rešavanja problema.
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- **Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije koju je imao i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- **Izveštaj Kosovskog fonda penzione štednje (Trust)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Procedura prijave:

- Zadnji rok za prijavu je **29 april 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik podnošenja prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: www.bqk-kos.org



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Auditor/e
Grada e pozitës:	pesë (5)
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Njësia:	e Auditimit të Pajtueshmërisë (NjAP)
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë:	Udhëheqësi/ja i/e Njësies së Auditimit të Pajtueshmërisë

Qëllimi dhe Fushëveprimi i Pozitës:

Auditori/ja i/e Njësies së Auditimit të Pajtueshmërisë kryen auditime të pajtueshmërisë, financiare, të performancës, të kombinuara, auditimin e Menaxhmentit, hulumtime paraprake të aktiviteteve të caktuara operative dhe funksionale, si dhe bën vlerësimin e efektshmërisë së kontrolleve të brendshme të këtyre aktiviteteve.

Auditori/ja i/e Njësies së Auditimit të Pajtueshmërisë punon nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Udhëheqësit/es të/së kësaj njësie.

Fushëveprimi i punës për këtë pozitë është si në vijim:

- Auditimet e Brendshme;
- Sistemet dhe procedurat dhe çështjet tjera administrative;
- Trajnimi dhe zhvillimi.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

Auditimet e Brendshme:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin/en merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për kryerjen e auditimeve dhe shërbimeve tjera përkatëse;
- Kryen auditime të brendshme, zhvillon intervista me stafin (personelin), merr dhe analizon dokumentacionin përkatës në përputhje me objektivat e BQK-së dhe në linjë me Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, etj;
- Kryen auditime të rregullta apo me kërkesë, mbi përdorimin e efektiv të resurseve të BQK-së, përpilon draft-raportet, diskuton rezultatet me mbikëqyrësin/en dhe auditorët tjerë të njësies, si dhe harton raportet finale mbi angazhimin e tij/saj;
- Në rastet të caktuara udhëheq ekipin e auditimit gjatë kryerjes së aktiviteteve audituese;
- Merr pjesë aktivisht në diskutime me auditorët e brendshëm, finalizon dosjen e auditimit dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm apo Auditorët e Jashtëm;
- Ofron këshilla për çështje të auditimit sipas nevojës;
- Zbaton Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës, si dhe të gjitha aktet tjera me të cilat rregullohet fushëveprimtaria e auditimit të brendshëm.

Sistemet/procedurat dhe çështjet administrative:

- Kryen shqyrtimet e pavarura të sistemeve ekzistuese apo të propozuara nëpër të gjitha entitetet e BQK-së (departamentet, divizionet, si dhe fushat tjera relevante), duke dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre;
- Vlerëson efektshmërinë dhe efikasitetin e të gjitha sistemeve të rëndësishme të kontrollit të brendshëm, monitoron performancën, duke dhënë rekomandime për përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Teston operimet e sistemeve në BQK, besueshmërinë dhe tërësinë e informatave, si dhe transakcionet e gjeneruara sipas ligjeve, politikave, procedurave, planeve dhe rregulloreve me të cilat qeveriset BQK-ja;
- Jep kontribut përgjatë përgatitjes së Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm;
- Kryen punë administrative sipas nevojave të Udhëheqësit/es të/së Njësies së Auditimit të Pajtueshmërisë, apo Shefit të Auditimit të Brendshëm.

Trajnimi dhe zhvillimi:

- Të ketë gatishmëri për të marrë pjesë në trajnime relevante për auditime të brendshme dhe të ofroj ndihmën e duhur për pjesën tjetër të Njësies së Auditimit të Pajtueshmërisë apo Auditimit të Brendshëm në përgjithësi, në rastet kur kërkohet;
- Të dëshmojë se ai/ajo është duke i zhvilluar aftësitë e tij/saj në dobi të Bankës Qendrore dhe Auditimit të Brendshëm, brenda saj.

Përgatitjet Profesionale/Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, kontabilitetit, menaxhmentit, apo juridike;
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale, prej tyre një (1) vit përvojë pune në fushën e auditimit të brendshëm apo të jashtëm;
- Certifikata profesionale në fushën e auditimit të brendshëm apo të jashtëm të sektorit publik/privat konsiderohet përparësi;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje, si dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar (Gjuha angleze e preferueshme);
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raportin nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /noshtrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **29 prill 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta:	Revizor
Stepen pozicije:	pet (5)
Trajanje zaposlenja:	na neodređeno vreme
Jedinica:	Revizije usaglašenosti (JRU)
Direktni nadzornik:	Rukovodilac Jedinice za reviziju usaglašenosti

Svrha i obim pozicije:

Revizor Jedinice za reviziju usaglašenosti vrši reviziju usaglašenosti, finansija, učinka, kombinovane, reviziju menadžmenta, preliminarne istraživanja pojedinih operativnih i funkcionalnih aktivnosti, kao i ocenu efikasnosti unutrašnjih kontrola ovih aktivnosti.

Revizor Jedinice za reviziju usaglašenosti radi pod neposrednim nadzorom rukovodioca ove jedinice.

Obim poslova za ovu poziciju je sledeći:

- Unutrašnje revizije;
- Sistemi i procedure i druga administrativna pitanja;
- Obuka i razvoj.

Dužnosti i odgovornosti:

Unutrašnje revizije:

- U saradnji sa nadzornikom/com učestvuje u izradi plana revizije i odobrava planove rada i rokove za obavljanje revizija i drugih relevantnih usluga;
- Vršiti unutrašnje revizije, obavlja intervju sa osobljem, prima i analizira relevantnu dokumentaciju u skladu sa ciljevima CBK-a i u skladu sa Zakonom o Centralnoj banci Republike Kosovo, Statutom unutrašnje revizije, Priručnikom za unutrašnju reviziju, itd.;
- Vršiti redovne revizije ili na zahtev o efektivnom korišćenju resursa CBK-a, sastavlja nacrt izveštaja, diskutuje o rezultatima sa nadzornikom i drugim revizorima jedinice, kao i sastavlja završne izveštaje o njegovom/njenom angazovanju;
- U određenim slučajevima vodi revizorski tim tokom obavljanja revizorskih aktivnosti;
- Aktivno učestvuje u diskusijama sa unutrašnjim revizorima, finalizuje dosije revizije i prati sprovođenje preporuka datih od strane unutrašnje revizije ili spoljnih revizora;
- Pruža savete o pitanjima revizije po potrebi;
- Sprovodi Zakon o Centralnoj banci Republike Kosovo, Statut Unutrašnje revizije, Priručnik Unutrašnje revizije, Etički kodeks, kao i sve druge akte koji regulišu delokrug unutrašnje revizije.

Sistemi/procedure i administrativna pitanja:

- Vršiti nezavisne preglede postojećih ili predloženih sistema u svim subjektima CBK-a (odeljenja, oseka, kao i druge relevantne oblasti), dajući preporuke za njihovo poboljšanje;
- Ocenjuje efektivnost i efikasnost svih važnih sistema unutrašnje kontrole, prati rad, dajući preporuke za unapređenje funkcionisanja sistema unutrašnje kontrole;
- Testira rad sistema u CBK-u, pouzdanost i potpunost informacija, kao i transakcije generisane u skladu sa zakonima, politikama, procedurama, planovima i uredbama kojima se upravlja CBK;
- Daje doprinos tokom pripreme Godišnjeg plana Unutrašnje revizije;
- Obavlja administrativne poslove prema potrebama rukovodioca Jedinice za reviziju usaglašenosti, odnosno šefa/ice Unutrašnje revizije.

Obuka i razvoj:

- Da bude spreman da učestvuje u relevantnoj obuci za unutrašnje revizije, kao i da pruži odgovarajuću pomoć ostaku Jedinice za reviziju usaglašenosti ili Unutrašnje revizije uopšte, u slučajevima kada je to potrebno;
- Da dokaže da razvija svoje veštine za dobro Centralne banke i Unutrašnje revizije, u okviru nje.

Stručna sprema/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, računovodstva, menadžmenta ili prava;
- Najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva, od kojih jedna (1) godina radnog iskustva u oblasti unutrašnje ili spoljne revizije;
- Profesionalni sertifikat iz oblasti unutrašnje ili spoljne revizije javnog/privatnog sektora smatra se prednošću;
- Odlične veštine organizacije, planiranja i upravljanja vremenom;
- Odlične međuljudske i komunikacijske veštine, kao i veštine rešavanja sukoba;
- Tačnost, pažnja na detalje kao i osetljivost na prioritete;
- Odlično poznavanje korišćenja softverskih aplikacija MS Office paketa;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika govornog i pisanog (poželjno engleski jezik);
- Da ima sposobnost da efikasno radi u multietničkom i multikulturinom okruženju.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prapatno (motivaciono) pismo koje navodi vaše interesovanje za ovu poziciju;
- **Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, bez ugrožavanja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka);
- **Izveštaj iz Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (ATK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/noshtrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak apliciranja:

- Krajnji rok za apliciranje je **29 april 2024**.
- Apliciranje se može vršiti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Ostali oblici apliciranja neće se razmatrati.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministraskvo Pravde - Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 15.04.2024

Referenca: AAPSK - 004/2024

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/ copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Opel Astra, 1.7 DTI, viti i prodhimit 2002, dizel,ngjyrë e kaltërt e mbyllët-për pjesë-Rishpallje	1 copë/ për pjesë	500.00€		
2	VW Polo ngjyre e hirit, benzin - për pjesë	1 copë/ për pjesë	500.00€		
3	Audi 80, model 89,viti i prodhimit 1990, dizel,ngjyrë e kuqe-për pjesë	1 copë/ për pjesë	300.00€		
4	Golf II viti i prodhimit 1987,dizel, ngjyrë e kuqe-për pjesë	1 copë/ për pjesë	300.00€		
5	VW Vento viti i prodhimit 1994,benzin, ngjyrë e hirit metalike -për pjesë	1 copë/ për pjesë	350.00€		
6	Golf III, viti i prodhimit 1992,benzin, ngjyre e kuqe. -për skrap	1 copë/ për skrap	231.15€		
7	Auto Bus, VDL,model SB 4000 viti i prodhimit 2009, dizel,ngjyrë e kalter-bardhë e kuqe, me targa të huaja-Rishpallje	1 copë	22,500.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 22.04.2024 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 22.04.2024, prej orës 10:00-11:00 në **Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.**

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapks.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Agon Reznici nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e lëshuar nga Q.A.O. në Gjakovë Instalues i Elektrikes.

- Naser Bordoniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Faton Babuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "N. Nixha" Aotomekanik Gjakovë.

- Driton Bajram Halabaku shpall të pavlefshme Diplomën e Masterit, drejtimi Juridik-Civil me nr. 895 të Universitetit "Hasan Prishtina" Prishtinë,

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma

të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu-ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Agon Reznici nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e lëshuar nga Q.A.O. në Gjakovë Instalues i Elektrikes.

- Naser Bordoniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Faton Babuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "N. Nixha" Aotomekanik Gjakovë.

- Driton Bajram Halabaku shpall të pavlefshme Diplomën e Masterit, drejtimi Juridik-Civil me nr. 895 të Universitetit "Hasan Prishtina" Prishtinë,

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

